



Dy shtete, një ekonomi

**Integrimi Ekonomik dhe Tregtar
i Shqipërisë dhe Kosovës**

Janar 2020



Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT) është një institut kërkimor (think-tank), veprimtaria e të cilit përqendrohet në qeverisjen dhe zhvillimin ekonomik. Misioni i ACIT është përmirësimi i performancës së ekonomisë shqiptare dhe konkurrueshmërisë së saj, rritja e integritit ekonomik me BE-në dhe rajonin, dhe promovimi i eksporteve dhe investimeve. Me anë të një sërë aktiviteteve hulumtuese dhe advokuese, ACIT ndihmon në rritjen e cilësisë së qeverisjes ekonomike si një instrument i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe zhvillimin, si dhe rritjen e përfitimeve të shoqërisë dhe qytetarëve nga mundësitë e hapjes dhe integritit ekonomik.

DY SHTETE, NJE EKONOMI:

Integrimi ekonomik dhe tregtar i Shqipërisë dhe Kosovës

Janar 2020.

Botuar nga Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare, 2020.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Studimi “Dy shtete, një ekonomi: Integrimi Ekonomik dhe Tregtar i Shqipërisë dhe Kosovës”, është pjesë e projektit “Shqipëri – Kosovë, Dekonstruktimi i idesë së bashkimit – Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin mes dy vendeve”. Ky projekt është iniciuar dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave	5
Lista e figurave	5
Lista e shkurtimeve	6
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Hyrje	9
2. Bashkëpunimi ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës	12
3. Tregtia midis Kosovës dhe Shqipërisë	14
3.1. Eksportet e Shqipërisë në Kosovë: Dinamika dhe struktura	14
3.2. Importet e Shqipërisë nga Kosova: Dinamika dhe struktura	19
3.3. Vlerësimi i avantazheve krahasuese (RCA) mes dy vendeve	24
3.4. Analiza e shkëmbimeve tregtare ndër-sektoriale (Grubel-Lloyd Index)	27
3.5. Potencialet e mëtejshme për shkëmbime tregtare midis dy vendeve	29
4. Barrierat jo-tarifore	31
5. Zbatimi i marrëveshjeve	35
6. Përfundime dhe rekomandime	41
6.1. Udhërrëfyes për krijimin e një ekonomie të unifikuar (Vizioni 2030)	43
Referenca	46
Shtojca 1. Indeksi i Avantazheve Krahasuese të tregtisë Shqipëri - Kosovë	47
Shtojca 2. Indeksi Grubel-Lloyd për tregtinë midis industrive	50
Shtojca 3. Përmbledhje e detajuar e gjetjeve nga pyetësorët me sipërmarrësit mbi barrierat tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës.	53

Lista e tabelave

Tabela 1. Volumi dhe dinamika e shkëmbimeve ekonomike Shqipëri - Kosovë	12
Tabela 2. Struktura gjeografike e eksporteve të Shqipërisë	14
Tabela 3. Lista e grup-produkteve më të eksportuara nga Shqipëria në Kosovë, 2018	18
Tabela 4. Lista e grup-produkteve më të eksportuara nga Shqipëria në Kosovë, 2013	18
Tabela 5. Struktura gjeografike e importeve të Shqipërisë	19
Tabela 6. Lista e grup-produkteve më të importuara nga Kosova, 2018	23
Tabela 7. Lista e grup-produkteve më të importuara nga Kosova, 2013	23
Tabela 8. Indeksi Grubel-Loyd për shkallën e shkëmbimeve tregtare ndër-sektoriale	28

Lista e figurave

Figura 1. Investimet e Huaja Direkte të Shqipërisë në Kosovë	13
Figura 2. Raporti i Vizitorëve nga Kosova ndaj totalit të vizitorëve në Shqipëri	13
Figura 3. Gjeografia e eksporteve të Shqipërisë	15
Figura 4. Dinamika e eksporteve të Shqipërisë	15
Figura 5. Struktura e eksporteve sipas kapitujve	16
Figura 6. Norma vjetore e ndryshimit të eksporteve, e mesatarizuar	17
Figura 7. Gjeografia e importeve të Shqipërisë	20
Figura 8. Dinamika e importeve të Shqipërisë	20
Figura 9. Struktura e importeve sipas kapitujve	21
Figura 10. Norma vjetore e ndryshimit të importeve, e mesatarizuar	22
Figura 11. Dinamika e indeksit të avantazheve krahasuese Shqipëri-Kosovë	26
Figura 12. Sektorët me avantazh krahasues bilateral në intervalin [10:1]	27
Figura 13. Vlerësimi i potencialeve të tregtisë Shqipëri-Kosovë	30
Figura 14. Udhërrëfyesi për integrimin ekonomik 2030	46

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
BRCA	Indeksi i avantazheve krahasuese dypalëshe
CEFTA	Zona e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
EFTA	Zona Evropiane për Tregtinë e Lirë
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
HS	Harmonized System
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
PEM	Marrëveshja Rajonale Pan Euro-Mesdhetare
RCA	Indeksi i avantazheve krahasuese
RITP	Potencialet Tregtare Indikative të Relativizuara
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij studimi është nxitja dhe përsheptimi i integritit ekonomik dhe tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke ndërgjegjësuar politikëbërjen, institucionet dhe komunitetin e biznesit të përfshirë në procesin e eliminimit të barrierave tregtare ekzistuese, mbi potencialet e pashfrytëzuara dhe fushat prioritare.

Për këtë qëllim, është bërë një analizë e mirëfilltë statistikore mbi të dhënat e tregtisë si dhe një studim i thelluar i potencialeve tregtare, duke përdorur teknika të eksplorimit të strukturuar të të dhënave. Gjithashtu, pjesë e studimit ishte edhe identifikimi i barrierave ekzistuese midis ekonomive të dy vendeve si dhe monitorimi i stadit të zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe që vendet kanë nënshkruar për lehtësimin e tregtisë dhe integrimin ekonomik. Për të patur një pasqyrë sa më të saktë dhe koherente të kësaj pjese, studimi ka përfshirë edhe gjetjet e një pyetësoi të plotësuar nga përfaqësues të botës së biznesit, si dhe intervista të thelluara me përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në hartimin dhe monitorimin e politikave të nxitjes së bashkëpunimit ekonomik midis vendeve.

Gjetjet kryesore mbi tregtinë

- Pavarësisht rritjes së flukseve tregtare dhe bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve në 10 vitet e fundit, dy ekonomitë paraqesin dobësi strukturore të cilat pengojnë shkëmbimet ekonomike të shfrytëzojnë potencialet;
- Një nga problemet kryesorë është përqëndrimi shumë i madh i tregtisë, vetëm 4 grup-produkte zënë mbi 80% të tregtisë;
- Flukset tregtare të detajuara sipas sektorëve janë të paqëndrueshme. Kjo paqëndrueshmëri dëmton konkurrueshmërinë e ekonomive dhe tërheqjen e investimeve.
- Midis kategorive që tregtohen, ka një potencial të madh të pashfrytëzuar për shkak të kostove dhe barrierave që ulin avantazhet. Kështu, në sektorë si agro-përpunimi dhe industria ushqimore, punimet artizanale, prodhime druri dhe qelqi, përpunimi i plastikës dhe metaleve, etj. rezulton një mundësi për të dyfishuar shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës;
- Potenciali është akoma më i madh dhe i qëndrueshëm për specializim të bashkëpunimit ekonomik dhe rritje të konkurrueshmërisë, me anë të konsolidimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet shkëmbimeve ndër-sektoriale, në fusha si agro-përpunim, industri kimike dhe kozmetike, prodhim artikuj paketimi prej plastike dhe letre, përpunim i metaleve, etj.;
- Nga sektorët e pashfrytëzuar deri tani, potencial për shkëmbime tregtare shfaqin sektorësi tekstile, prodhime lëkure, makineri, prodhimet e detit, produkte druri të përpunuar, etj.

Gjetjet kryesore mbi pengesat

- Mungesa e theksuar e besimit që konstatohet nga administratat përkatëse, krijon shpesh bllokime dhe vonesa në zhvillimin e tregtisë. Kjo reflektohet edhe në mosnjohjen reciproke të disa prej dokumentacioneve dhe certifikimeve bazë që shoqërojnë procesin;
- Mundësitë eksportuese dhe potenciali konkurrues preken direkt nga kostot e larta të transportit, si dhe praktikat e zhdoganimeve: kohëzgjatja dhe inspektimet e shpeshta;
- Kosto të tjera që raportohen rregullisht nga biznesi janë pagesat e larta të skanimit (edhe kur nuk skanohen), tarifa parkimi, peshimi, etj. të gjitha me tarifa mbi koston efektive;
- Mospublikimi i çmimeve të referencës dhe aplikimi rast pas rasti nga Dogana e Kosovës;
- Kufizime edhe nga pamundësia e zbatimit të rregullave të kumulimit diagonal të origjinës;
- Pavarësisht nënshkrimit të marrëveshjeve, zbatimi i tyre paraqet probleme dhe vështirësi. Shumica e tyre ka nevojë për dispozita dhe akte shtesë për të garantuar zbatimin;
- Vullneti politik nuk është përkthyer dot në mënyrë të kënaqshme në zbatim, sidomos nga nivelet më të ulëta të administratës. Kjo sidomos për barrierat kryesore e më problematike.

Rekomandimet

Për të zhvilluar më tej tregtinë dhe për të integruar ekonomikisht dy vendet, duhet (1) një vëmendje e shtuar ndaj zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara. Fokusi duhet të jetë sidomos tek (2) sektorët që konsolidojnë zinxhirin e vlerës dhe kategorive që kanë potencial konkurrues. Këta sektorë kanë nevojë (3) për politika mbështetëse zhvillimore. Gjithashtu (4) duhen hequr edhe barrierat të tjera ekzistuese që frenojnë integrimin ekonomik, duke lejuar të drejtën e njehsuar të vendosjes dhe themelimit të biznesit në të dy vendet. Duhet (5) një angazhim i strukturuar për bashkimin e dy ekonomive, si e vetmja mënyrë për të tërhequr investime dhe për të qenë (bashkarisht) më të fuqishëm për ti bërë ballë presionit konkurrues të jashtëm.

Për të arritur qëllimet e mësipërme dhe për të shtyrë përpara efektivisht integrimin ekonomik midis dy vendeve, studimi propozon disa hapa konkretë, në **Udhërrëfyesin** për 2030:

1. Ngritja e një strukture të lartë dypalëshe (Direktorat), me detyrë monitorimin dhe shpejtimin e zbatimit të marrëveshjeve, heqjen e barrierave dhe ndjekjen e hapave të tjerë si më poshtë;
2. Krijimi i Fondit të Përbashkët të Investimeve, si instrument për mbështetjen e projekteve strategjike që përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe lehtësojnë integrimin ekonomik;
3. Dokumenti strategjik 10-vjeçar për harmonizimin e politikave të zhvillimit ekonomik
4. Hartimi i planit të veprimit për të zbatuar strategjinë, i ndarë në dy faza:
 - Pesë vitet e para për eliminimin e barrierave, rishikim të kostove të biznesit, unifikim dhe standardizim të dokumentacionit, plane strategjike për sektorët me potencial për vlerë të shtuar;
 - Faza e dytë, me skema të përbashkëta mbështetëse për sektorët strategjikë si dhe koordinimi i politikave ekonomike dhe buxhetore, me projekte madhore në energji dhe infrastrukturë.

1. Hyrje

Prirjet e liberalizimit tregtar, nëpërmjet eliminimit të barrierave tregtare, tarifore dhe jo-tarifore, kanë vazhduar të thellohen në mënyrë të vazhdueshme në nivel global nga njëri raund negociatash të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), në tjetrin. Paralelisht me këto procese që kanë ndodhur në shkallë globale, krijimi i zonave të tregtisë së lirë mbi baza më të ngushta rajonale është intensifikuar gjithashtu, veçanërisht pas viteve 1990. Ky konflikt midis globalizimit dhe rajonalizimit mund të jetë dhe një nga shkaqet e ngërceve me të cilat sot po ndeshen politikat tregtare në shkallë globale, përfshirë këtu dhe mungesën e vullnetit për të përmbyllur negociatat e Raundit të Dohas të nisur që në vitin 2001, si dhe ashpërsimin e konfliktit tregtar midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Kinës dhe Bashkimit European (BE). Duket se nacionalizimi ekonomik për momentin është në rritje dhe kjo përfaqëson një rrezik global për rritjen ekonomike dhe mirëqenien e njerëzimit.

Shqipëria është përfshirë aktivisht në një proces të liberalizimit tregtar, që nga vitet 1990, fillimisht në mënyrë të njëanshme, për shkak të përfitimeve të njohura ekonomike që krijon liberalizimi i tregtisë për konsumatorin dhe ekonominë. Më vonë, liberalizimi tregtar është institucionalizuar në sajë të anëtarësimit në OBT në shtator të vitit 2001. Në këtë periudhë Shqipëria u angazhua dhe në negocimin të rrjetit bilateral të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe zëvendësimin e tyre me anëtarësimin në Zonën e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), në dhjetor 2006. Po në të njëjtin vit, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në e cila ka hyrë në fuqi prej vitit 2009. Vendet e Ballkanit Perëndimor (6) kanë aktualisht një Plan Shumëvjeçar Veprimi për krijimin e Zonës Ekonomike të Përbashkët me masa që duhen zbatuar deri në vitin 2023 dhe që fokusohen në katër komponentë kyçe: Tregti, Investime, Mobilitet dhe Integrimin dixhital. Shqipëria ka gjithashtu një marrëveshje të tregtisë së lirë dhe me vendet anëtare të Zonës Evropiane për Tregtinë e Lirë (EFTA) që prej vitit 2011.

Kosova nga ana e saj nuk ka shënuar ndonjë marrëveshje të tregtisë së lirë me ndonjë vend tjetër jashtë CEFTA-s. Marrdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës janë të kornizuara si nga angazhimet e përbashkëta që dy vendet kanë ndërmarrë në kuadër të CEFTA-s, por edhe nga një numër gjithnjë në rritje marrëveshjesh dypalëshe të nënshkruara që prej vitit 2003, e që kanë marrë një hov më të madh pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Aktualisht numërohen më shumë se 50 marrëveshje të bashkëpunimit dypalësh.

Liberalizimi tarifave doganore në tregtinë Shqipëri-Kosovë ka ndodhur në mënyrë të shpejtë dhe më herët nga sa ka ndodhur me vendet e tjera të CEFTA-s. Sipas Raportit të OBT-së që analizon ecurinë e marrëveshjes së CEFTA-s (OBT 2019), tregtia pa tarifa doganore mes dy vendeve ka nisur e plotë që në vitin 2007, ndërsa liberalizimi tregtar nga ana e Shqipërisë me vendet e tjera ka përfunduar gradualisht deri në vitin 2011 (me Bosnje Hercegovinën në vitin 2014). Nga ana e saj, Kosova i kishte eliminuar tarifat doganore me të gjitha vendet e rajonit menjëherë që në vitin 2007, me përjashtim të 149 linjave tarifore me Maqedoninë e Veriut, të cilat u liberalizuan në vitin 2008.

Shkëmbimet tregtare Shqipëri-Kosovë janë intensifikuar ndjeshëm dhe janë rritur me norma vjetore mjaft të larta gjatë 5-vjeçarit të fundit. Zhvillimi ekonomik i dy vendeve i ri-kthyer në trajektore pozitive të rritjes ekonomike, angazhimi politik dhe institucional dy-palësh si dhe forcimi i integritetit dhe shkëmbimeve ekonomike rajonale në kuadër të CEFTA-s kanë qenë faktorë nxitës të bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve.

Ndërsa liberalizimi i tarifave doganore është arritur relativisht shpejt, problematike në shkëmbimet tregtare mes dy vendeve mbeten barrierat jo-tarifore dhe teknike. Ato kanë qenë dhe burime të konflikteve tregtare midis dy vendeve dhe kanë tërhequr shpesh herë vëmendjen e opinionit publik. Prej më shumë se një dekade, që kur Kosova u bë shtet i pavarur, qeveritë nga të dy anët e kufirit duke respektuar vullnetit e qytetarëve të tyre dhe janë përpjekur që rrugën e zhvillimit të dy vendeve ta mendojnë të përbashkët. Ky ka qenë dhe qëllimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Por pavarësisht përpjekjeve të dy qeverive dhe vullnetit politik, shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve, lëvizja e lirë e kapitaleve dhe forcës së punës akoma hasin barriera dhe përballojnë kosto të cilat bien ndesh me frymën e bashkëpunimit mes dy vendeve.

Në të gjithë historinë e saj të tregtisë së lirë me jashtë, Shqipëria nuk njeh aq konflikte sa me Kosovën. Edhe Kosova nuk njeh pengesa në tregtinë me jashtë sa me Shqipërinë. Rezultati final ka qenë larg krijimit të një tregu të përbashkët, prej të cilit do të vinin të mirat ekonomike për të dy palët. Në thelb konfliktet nuk janë krijuar nga masa diskriminuese të zbatuara ekskluzivisht ndaj njëri-tjetrit, por ato janë zbatuar ndaj të gjithë vendeve të tjera. Për shembull, vendosja e akcizës së diferencuar nga Shqipëria mbi prodhimet alkoolike (birrë, verë) për prodhuesit me kapacitet mbi 1 milion litër, në thelb synon të mbrojë prodhuesit vendas të cilët janë përgjithësisht më të vegjël se prodhuesit e huaj, prej të cilëve importohen sasi të mëdha në Shqipëri. Por, kjo masë e cila aplikohet nga Shqipëria ndaj të gjithë importeve të këtyre produkteve nga jashtë vendit, preku edhe tre subjekte prodhuese nga Kosova të cilët dispononin kapacitete prodhuese mbi 1 milion litër në vit.

Konfliktet e tjera që lidhen me aplikimin e cmimeve referencë për prodhimet e hortikulturës, apo bllokimi i qumështit prodhuar në Shqipëri në tregjet e Kosovës për shkak të ndotësve, të ndjekur nga bllokimi i importit të mishit dhe të miellit nga Kosova si masë për mbrojtjen e konsumatorit, që u pasua nga masa kufizuese të eksportit të çimentos shqiptare në Kosovë. Në vazhdim të këtyre rastave, edhe taksat e aplikuar në tranzit apo transportin e mallrave janë episode të dëshëmshme për frymën e bashkëpunimit dhe krijimit të tregut të përbashkët mes dy vendeve e që duhen adresuar në mënyrë të qëndrueshme dhe sistematike, duke eliminuar mënyrën ad-hoc dhe momentale të zgjidhjes së këtyre problemeve.

Dinamika e shkëmbimeve ekonomike, të përfaqësuara nga shkëmbimet tregtare, turizmi dhe investimet e huaja mes dy vendeve, japin sinjale pozitive për domosdoshmërinë e thellimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit ekonomik. Shkalla e rritjes së eksporteve të Shqipërisë drejt Kosovës dhe anasjelltas rritja e eksporteve të Kosovës drejt Shqipërisë janë pozitive dhe mjaft të larta krahasuar me dinamikën e flukseve të shkëmbimit me vendet e tjera të rajonit apo dhe me botën. Pavarësisht dinamikës, struktura e shkëmbimeve tregtare dhe ekonomike mbetet e varfër dhe e përqëndruar në produkte me vlerë të shtuar të ulët. Kjo nuk mundëson krijimin e zinxhirëve të vlerës së shtuar mes dy vendeve, që do sillte aftësi

konkurruese të lartë në rajon apo më gjerë. Struktura e ngjashme e dy ekonomive është faktor nxitës për bashkëpunimin në nivel sektori duke nxitur konkurrueshmërinë e bazuar në ekonominë e shkallës dhe specializimin. Megjithatë, ky integrim mes ekonomive duket të jetë fillestar, ndërkohë që komunitetet e biznesit shprehen se dy vendet nuk kanë një qasje strategjike afatgjatë në këtë drejtim. Dy vendet nuk kanë identifikuar ende sektorë strategjike si bazë të nxitjes së shkëmbimeve ekonomike dhe konkurrueshmërisë rajonale dhe nuk kanë hedhur hapa të qëndrueshëm drejt integritimit ekonomik.

Qëllimi i këtij studimi është nxitja e procesit të integritimit ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve. Analiza dhe zbulimi i potencialeve ekonomike dhe tregtare midis dy vendeve, si dhe formulimi i disa rekomandimeve konkrete për politikëbërësit janë element kryesor në këtë punim. Për të arritur objektivin, studimi fillimisht analizon në thellësi marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis dy vendeve, identifikon potencialet e avantazheve konkurruese dhe të mundësive midis sektorëve, si dhe monitoron pengesat dhe barrierat ekzistuese, bashkë me zbatimin e deritanishëm të marrëveshjeve dypalëshe. Në fund, materiali mbyllet me një përmbledhje të rekomandimeve kryesore dhe hapave të sugjeruara për vendim-marrësit në formën e një udhërrëfyesi, drejt një integritimi ekonomik midis dy vendeve.

Krahas përpunimeve të ndryshme statistikore dhe përdorimin e modeleve të përpunimit të strukturuar të të dhënave, studimi ka patur si pjesë të metodologjisë edhe zbatimin e një pyetësoi me përfaqësuesit e bizneseve importuese dhe eksportuese të Shqipërisë me Kosovën, si dhe një sërë intervistash të thelluara me përfaqësuesit institucionalë që mbulojnë zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe integritimin ekonomik midis dy vendeve. Gjithashtu, në versionin draft, materiali është konsultuar gjerësisht me aktorë të fushës në dy aktivitete publike dhe më gjerë, me qëllim marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e rekomandimeve. Pas publikimit, studimi final do t'i shpërndahet politikëbërësve dhe përfaqësuesve institucionalë, duke synuar advokimin për të ndjekur udhërrëfyesin e hartuar dhe të rekomanduar nga ky hulumtim.

2. Bashkëpunimi ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës

Shkëmbimet tregtare Shqipëri-Kosovë janë rritur ndjeshëm sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Volumi i shkëmbimeve tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës gjatë vitit 2018, në vlerën 36 miliardë Lekë (295 milionë Euro), përfaqëson 3.8% të volumit tregtar total të Shqipërisë, ndërkohë që norma mesatare vjetore e rritjes së shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve për 5 vitet e fundit vlerësohet në 11%. Pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve e zënë eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës, të cilat përfaqësuan 75% të volumit tregtar në 2018, në vlerën prej 27 miliardë Lekë (222 milionë Euro).

Importet e Shqipërisë nga Kosova vlerësohen në rreth 9 miliardë Lekë, duke qëndruar 3 herë më të ulëta se eksportet. Rritmi mesatar vjetor i rritjes së importeve është i ngjashëm me atë të eksporteve dhe vlerësohet në 12%. Eksportet ngelen me dinamikë dhe volatilitet më të lartë nga viti në vit krahasuar me fluksin e importeve. Në flukset tregtare midis dy vendeve në përgjithësi, vihet re mungesa e qëndrueshmërisë.


Tabela 1: Volumi dhe dinamika e shkëmbimeve ekonomike Shqipëri - Kosovë

	2014	2015	2016	2017	2018
Eksport (në milionë Lekë)	18,774	20,921	16,605	20,924	27,093
Import (në milionë Lekë)	5,976	5,483	5,819	8,443	8,909
Volumi Tregtar (në milionë Lekë)	24,750	26,404	22,424	29,367	36,002
Raporti Eksport/Import	3.14	3.82	2.85	2.48	3.04
Raporti i eksporteve me Kosovën ndaj totalit (në %)	8.6%	6.8%	7.7%	8.7%	8.7%
Raporti i volumit tregtar me Kosovën ndaj totalit (në %)	3.4%	2.7%	3.3%	3.8%	3.8%
Raporti i IHD të Shqipërisë kundrejt totalit në Kosovë	13.5%	13.0%	13.0%	0.9%	8.2%
Raporti i vizitorëve të Kosovës ndaj totalit në Shqipëri	38%	41%	46%	34%	35%

Burimi: INSTAT; Banka e Shqipërisë; Drejtoria e Doganave; Përpunime të autorëve.

Shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve janë shumë më të gjera se vetëm flukset tregtare. Ato shtrihen në shkëmbime ekonomike në industrinë e turizmit, shërbimeve financiare, shkëmbime në fushën e arsimit dhe teknologjisë, transportit apo telekomunikacionit. Vetëm gjatë 2018, Investimet e Huaja Direkte (IHD) me origjinë nga Shqipëria drejt Kosovës u vlerësuan në 22.3 mln Euro, duke renditur Shqipërinë ndër investitorët më të rëndësishëm për Kosovën (shih figurën 1).


Figura 1. Investimet e Huaja Direkte të Shqipërisë në Kosovë



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Rëndësi të vecantë në shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve kanë ato në fushën e turizmit. Vizitorët që hyjnë në Shqipëri nga Kosova përfaqësojnë mbi 1/3 e totalit të vizitorëve të huaj. Ky raport është mjaft i qëndrueshëm dhe mbetet një nga faktorët kryesorë dhe mbështetës të zhvillimit të turizmit në Shqipëri.

Figura 2. Raporti i Vizitorëve nga Kosova ndaj totalit të vizitorëve në Shqipëri



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit; INSTAT

Integrimi i tregjeve të punës mes dy vendeve vazhdon të mbetet modest si rezultat i papunësisë së lartë dhe diferencës së ulët të pagave mesatare mes dy vendeve. Në lëvizjen e ulët të krahut të punës mes dy vendeve kanë ndikuar dhe pengesa administrative si procedurat e lejeve për punë apo ato të njohjes reciproke të kualifikimeve, pengesa që po tentohet të adresohen në kuadrin e nxitjes së bashkëpunimit mes dy vendeve. Integrimi i sistemit arsimor, sidomos I arsimit të lartë, njohjes reciproke të programeve të studimit dhe profesioneve është gjithashtu një faktor që nuk ndihmon shkëmbimet e tregut të punës. Të huajt që qëndrojnë në Shqipëri për qëllime punësimi, përfaqësojnë një raport mjaft të vogël të të punësuarve, vetëm 0.5% të të punësuarve. Ndër të huajt që vijnë për të punuar në Shqipëri, 11% janë me origjinë nga Kosova.

3. Tregtia midis Kosovës dhe Shqipërisë

3.1. Eksportet e Shqipërisë në Kosovë: Dinamika dhe struktura

Shqipëria eksportoi në tregun global, në vitin 2018, mallra në vlerën prej 310 miliardë Lekë, me rritje vjetore të eksportit në masën 14% (krahasuar me 2017). Eksportet shqiptare janë të orientuara kryesisht drejt tregut evropian, në të cilin u eksportuan 79% e totalit, me vlerë 244 miliardë Lekë. Eksportet drejt Ballkanit Perëndimor janë duke rritur gradualisht peshën relative ndaj totalit të eksporteve, duke pasqyruar rritjen e rëndësisë të rajonit kundrejt vendeve të tjera të botës. Eksportet drejt rajonit janë në masën më të madhe me destinacion tregun e Kosovës; pothuajse gjysma e eksporteve rajonale të Shqipërisë orientohet drejt Kosovës.

Eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës, në 2018, përfaqësuan 9% të volumit të eksporteve totale (shih tabelën 2), duke arritur vlerën prej 27,093 milionë Lekë (222 milionë Euro). Eksportet raportohen të jenë 29% më të larta në 2018, krahasuar me 2017, një normë rritjeje dy herë më e lartë se norma e rritjes së eksporteve në nivel kombëtar.

Tabela 2. Struktura gjeografike e eksporteve të Shqipërisë (në milionë Lekë)


	2014	2015	2016	2017	2018
Bashkimi Evropian	211,101	192,742	196,366	215,679	243,906
Rajoni	10,429	12,993	15,499	18,282	22,267
Kosova	18,774	20,921	16,605	20,924	27,093
Pjesa tjetër e botës	15,455	16,527	15,029	18,104	17,169
Totali i eksporteve	255,759	243,183	243,498	272,988	310,436

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Dinamika e eksporteve (shih figurën 3) pavarësisht luhatshmërisë, tregon për një zhvillim të shpejtë të tyre, rritja vjetore e të cilave është dyfishuar përgjatë 5 viteve të fundit. Si rezultat, eksportet me Kosovën zhvillohen me një ritëm më të shpejtë së eksportet me rajonin, botën apo BE-në. Megjithatë është e diskutueshme aftësia e ekonomisë së Shqipërisë për të siguruar qëndrueshmëri të eksporteve dhe gjithashtu aftësia e dy ekonomive për të akumuluar vlerë dhe për të eksportuar në rajon.


Tipari kryesor i eksporteve shqiptare drejt tregut të Kosovës është numri shumë i ulët i produkteve që tregohen (14 produkte zënë 85.5% të totalit të eksporteve), luhatshmëria e produkteve të tregtuara nga njëri vit në tjetrin dhe shkalla relativisht e ulët e përpunimit ose e vlerës së shtuar të tyre. Në fakt këto janë tipare të eksporteve shqiptare në tërësinë e tyre dhe jo thjesht vetëm me Kosovën.

Figura 3. Gjeografia e eksporteve të Shqipërisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.


Figura 4. Dinamika e eksporteve të Shqipërisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.


Eksportet kryesore të Shqipërisë drejt Kosovës përfaqësohen nga eksporti i materialeve të ndërtimit dhe metaleve, mineraleve dhe lëndëve djegëse, ushqimeve si dhe produkteve kimike dhe plastike. Struktura e eksporteve është mjaft e përqëndruar, ku eksportet e 4 kapitujve kryesorë sipas sistemit të harmonizuar HS2 (Harmonized System – HS) përfaqësojnë më shumë se 85% të totalit të eksporteve të Shqipërisë drejt Kosovës. Struktura e eksporteve duket të ketë një diversifikim të lehtë në vitin 2018, nëse e krahasojmë me strukturën e eksporteve në 2013. Eksporte si produkte vegjetale, ushqimet e përpunuara, veprat e artit, produkte të industrisë kimike, si dhe letra/kartoni kanë filluar të jenë pjesë më e rëndësishme e totalit të eksporteve në 2018 krahasuar me vitin 2013. Eksporte të sektorit të plastikës dhe gomës si dhe ato të artikujve prej guri e çimentoje kanë filluar të humbin peshë në totalin e eksporteve në 2018 krahasuar me 2013.

Figura 5. Struktura e eksporteve sipas kapitujve



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Figura 6. Norma vjetore e ndryshimit te eksporteve, e mesatarizuar



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Në vitin 2018, në listën e produkteve më të eksportuara shfaqen produkte të çelikut dhe gëzës, të cilat në vlerën prej 89 milionë Euro përfaqësojnë 44.6% të eksporteve shqiptare në Kosovë. Të rëndësishme ndër eksporte shfaqen edhe profilet e aluminit dhe konstruksione metalike të përdorura në ndërtimin e veprave të infrastrukturës. Materiale ndërtimi si çimento apo përbërjet stukturuese janë gjithashtu elementë të renditur ndër eksportet kryesore, pavarësisht se kanë një raport (në përqindje) ndaj totalit të eksporteve më të vogël se konstruksionet metalike.

Të rëndësishme në strukturën e eksporteve shfaqen prodhimet vendase të drurit/mobiliarisë si ndenjës (karrige e kolltukë) apo mobilje të tjera. Gjithashtu, edhe prodhimet bujqësore kanë peshë, ndër të cilat eksportin kryesor e zënë domatet, agrumet, pjepri, shalqin dhe kastravecat. Eksporti i ujërave minerale dhe natyrore është gjithashtu ndër 15 grup produktet më të eksportuara, por duke zënë vetëm 1% të vlerës së eksportit në 2018.

Krahasuar me produktet më të eksportuara në vitin 2013, duket që struktura e eksporteve ka një dinamikë dhe ndryshueshmëri të lehtë. Nafta dhe nënproduktet e saj si dhe materialet e ndërtimit ngelen elementët dominues të strukturës së eksporteve ndër vite. Shqipëria gjatë 2013 ka eksportuar edhe minerale të pa-përpunuara si psh xeherorë kromi. Produkti më i rëndësishëm bujqësor i eksportuar ka qënë pjepri, ndjekur nga domatet dhe vezët. Vezët nuk janë më ndër produkte bujqësore më të eksportuara në 2018.

Tabela 3. Lista e grup-produkteve më të eksportuara nga Shqipëria në Kosovë, 2018

HS4	Përshkrimi i grup-produkteve	Në millionë Lekë	% totali
7214	Shufra dhe shkopinj të tjerë prej gize dhe çeliku	10,963.2	44.6%
2710	Vajrat e naftës dhe vajra prej mineraleve bituminoze	2,670.9	10.9%
2523	Çimento	2,201.1	9%
2713	Koks naftë dhe mbetje të mineraleve bituminoze	1,263.3	5.1%
7604	Shufra, shkopinj dhe profile alumini	830.7	3.4%
0702	Domate, të freskëta apo te ftohta	646.6	2.6%
9619	Peshqiret sanitare	595.4	2.4%
3214	Stuko xhami, stuko transplatuese, cimente resini, përbërjet stukuese dhe mastice të tjera	378.4	1.5%
9401	Ndenjëset (të ndryshme nga ato të kreut 9402), nëse janë ose jo të kthyeshme në krevate dhe pjesët e tyre	283.2	1.2%
7308	Konstruksionet (përjashtojë parafabrikatet e kreut 9406) dhe pjesët e konstruksioneve	256.7	1%
0805	Agrumet, të freskëta apo te thara	240.3	1%
2201	Ujra, përfshirë ujërat minerale natyrore dhe ujërat e gazuar	235.9	1%
0807	Pjeprat dhe shalqinj të freskëta	226.2	0.9%
9403	Mobileri të tjera dhe pjesët e tyre	210.5	0.9%
	Totali	21,003	85.5%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Duket se prej vitit 2013, edhe pse eksportet shqiptare drejt Kosovës janë rritur, disa produkte kanë dalë nga portofoli tregtar duke e ngushtuar dhe përqëndruar edhe më shumë strukturën e eksporteve, siç dëshmojnë dhe të dhënat e tabelave 3 dhe 4.

Tabela 4. Lista e grup-produkteve më të eksportuara nga Shqipëria në Kosovë, 2013

HS 4	Pershkrimi i Produkteve	Në milionë Lekë	% totali
2710	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze	1,563.6	22%
7214	Shufra dhe shkopinj të tjerë prej gize dhe çeliku	1,367.1	19%
2523	Çimento portland, çimento oksidalumini, çimento skorjesh, çimento supersulfati dhe çimento të ngjashme hidraulike	782.4	11%
2713	Koks Naftë, bitumi dhe mbetje të tjera	391.9	6%
2601	Xeherore dhe koncentre hekuri, piriti e pjekur të hekurit	235	3%
7604	Shufra, shkopinj dhe profile alumini	231.7	3%
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera të lëngshme	185.3	3%
6904	Tullat ndërtuese, pllaka mbështetëse, blloqet e dyshemeve	174.9	2%
0807	Pjeprat (përfshirë shalqinj të)	117.4	2%
1512	Vaj luledielli dhe fraksione të tyre	102.4	1%
2610	Xeherore dhe koncentre kromi	101.4	1%
9706	Antikat	100.6	1%
3214	Stuko xhami, stuko transplatuese, cimente resini, preparatet jo refraktare sipërfaqësore për fasada, mure të brendshme	94.6	1%

3102	Plehëruesit minerale apo kimike, azotike	75.5	1%
2501	Kripë (duke përfshirë kripën e tavolinës dhe kripën e denatyrar) dhe klorur natriumi i pastër	74.5	1%
2604	Xeherore dhe koncentre nikel	71.4	1%
0702	Domate, të freskëta apo të ftohta	67.6	1%
3103	Plehëruesit minerale apo kimikë, fosfatike	52.6	1%
0407	Vezët e zogjve, në guackë, të freskëta, të ruajtura apo të gatuar	45.2	1%
4813	Letër cigaresh	42.9	1%
	Totali	5,879.1	83%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

3.2. Importet e Shqipërisë nga Kosova: Dinamika dhe struktura

Shqipëria importoi në total 641 miliardë Lekë (5,2 miliardë Euro) mallra gjatë 2018 për të plotësuar kërkesën konsumatore apo atë të ndërmjetme të brendshme. Importet janë gati dyfishi i eksporteve dhe deficitit tregtar vlerësohet në 330 miliardë Lekë (2,7 miliardë Euro).


Tabela 5. Struktura gjeografike e importeve të Shqipërisë

	2014	2015	2016	2017	2018
Bashkimi Evropian	412,939	407,406	437,109	463,763	474,250
Rajoni	34,324	32,396	28,545	37,483	33,553
Kosova	5,976	5,483	5,819	8,443	8,909
Pjesa tjetër e botës	99,042	99,332	107,776	116,496	124,754
Totali i importeve	552,281	544,616	579,248	626,186	641,466

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.


Importet janë rritur me vetëm 2% gjatë 2018, krahasuar me një vit më parë. 74% e importeve në 2018 origjinonin nga vendet e Bashkimit Evropian. Importet nga ekonomitë rajonale përfaqësojnë 5% të totalit, ndërsa importet nga Kosova përfaqësojnë vetëm 1% të totalit të importeve, duke regjistruar një vlerë prej 8,9 miliardë Lekë (73 milionë Euro). Importet nga Kosova u rriten me 8% në 2018 krahasuar me 2017 (shih tabelën 5 dhe Figurën 8).

Figura 7. Gjeografia e importeve të Shqipërisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.


Figura 8. Dinamika e importeve të Shqipërisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Ashtu si dhe në rastin e eksporteve, edhe struktura e importeve të Shqipërisë nga Kosova është shumë e përqëndruar: 4 seksione sipas HS2 ofruan 93% të importeve (në 2013). Kjo strukturë duket të ketë humbur pak nga përqëndrimi në vitin 2018, duke qënë se 4 grup produktet kryesore të importuara përfaqësojnë 84% të totalit. Struktura e përqëndruar dhe e padiversifikuar si në anën e eksporteve dhe atë të importeve reflekton strukturën dhe dobësitë e dy ekonomive.

Figura 9. Struktura e importeve sipas kapitujve




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Importet kryesore të Shqipërisë nga Kosova përfaqësohen nga metalet të cilat sillen në Shqipëri për ri-përpunim (skrap hekuri dhe alumini përgjithësisht). Ky element importi është një formë e tregtisë ndër-sektoriale, pasi metalet mbasi përpunohen, ri-eksportohen në Kosovë, si shufra hekuri, profile dhe forma të tjera të metaleve të përpunuara të vlefshme për sektorin e ndërtimit. Kjo kategori importesh ka humbur rëndësi në strukturën e importeve duke i lënë hapësirë importeve të produkteve me vlerë të shtuar dhe përpunim në Kosovë si psh. ushqime të përgatitura, produkte vegjetale, prodhime prej plastike dhe gome si dhe letre e kartoni.

Dinamikat dhe ndryshimet më të forta vihen re shpesh në sektorë marxhinale për sa i përket volumit me të cilin përfaqësohen në strukturën e importeve. Ky tipar vihet re edhe në strukturën e eksporteve. Kështu kafshët e gjalla, prodhimet e lëkurës dhe tekstileve si dhe artikuj prej guri shfaqin norma ndryshimi (rritjeje) mesatare mjaft të larta. Dinamika të forta pozitive kanë edhe prodhimet e industrisë kimike. (shih figurën 6)

Figura 10. Norma vjetore e ndryshimit të importeve, e mesatarizuar



Burimi: Përpunime të autorëve.

Një vështrim në listën e 20 produkteve më të importuara në Shqipëri nga Kosova për vitin 2018 vihet re se produktet më të importuara mbeten mielli, ujrë mineral apo natyrorë, birra prej malti, verë, si dhe sallamët e përpunuara prej mishit. Produktet e importuara në këtë kategori kanë mundur që ushqimet e përpunuara të zënë 25% të importeve nga 10% që zinin në vitin 2013.

Produktet e tjera të importuara në 2018, dhe jo prezente në vitin 2013 përfshijnë dhe produkte që përdoren për paketim prej letre, kartoni, qelqi dhe plastike. Të rëndësishme janë importet e materialeve të ndërtimit që përdoren në termo-izolim (apo izolimin e zërit). Importet në këtë kategori zënë 7% të totalit të importeve në vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2013 ato ishin vetëm 0.13% e totalit të importit. Në vitin 2018 në strukturën e importeve shfaqen edhe produktet e industrisë kimike me gati 2% të importeve, ndërkohë që në 2013 mungonin.

Sektorët që përfaqësohen në vlera të ulëta në strukturën e importeve janë tekstilet dhe veshjet e këmbëve, prodhimet e lëkurës si dhe kafshët e gjalla. Shkëmbimet në fushën e aparaturave që përdoren në industrinë e filmimit, shkëmbimet në fushën e artit janë shfaqur në strukturën e importit gjatë 2018, duke zënë 2.1% të volumit të importeve.

Tabela 6. Lista e grup-produkteve më të importuara nga Kosova, 2018

HS4	Përshkrimi	Në milionë Lekë	% totali
7204	Kthime dhe mbetje të rishkrirëshme prej gize dhe çeliku:	2,523.1	28.3%
2203	Birrë bërë nga malti	1,241.9	13.9%
7304	Tuba, tubacione dhe profile të linjëzuara të përdorur për linja gazi dhe nafte	989.4	11.1%
2202	Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	429.1	4.8%
7602	Mbetje dhe kthime alumini	395.7	4.4%
1101	Miell gruri dhe miell meslini	288.3	3.2%
3917	Tuba, pipa dhe zorra prej materialeve celulozike	245.6	2.8%
3921	Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike	186.2	2.1%
4819	Kartonët, kutitë dhe konteniere paketues prej letre, kartoni	143.1	1.6%
7306	Tuba, tubacione dhe profile prej gize dhe çeliku	141.3	1.6%
2204	Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool	136.5	1.5%
2302	Krundet, mbetjet nga sitja, bluarja e drithrave apo të bimëve leguminoze	135.4	1.5%
6810	Përzierjet dhe artikujt e materialeve minerale termoizolues, akustiko izolues apo akustiko absorbues	119.8	1.3%
7010	Damixhane, shishe apo konteniere të tjerë, prej qelqi për paketim	110.0	1.2%
7308	Konstruksionet (përfshijto parafabrikatet) prej gize apo çeliku	107.2	1.2%
4403	Dru i papërpunuar	106.4	1.2%
1601	Sallam dhe produkte të ngjashme;	89.4	1.0%
9404	Mbështetëset dhe mbajtëset e dyshekëve; artikujt të krevatëve	79.0	0.9%
701	Patate të freskëta dhe të ftohta	78.9	0.9%
3923	Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej plastike	69.6	0.8%
	Totali	7,615.8	85.3%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Tabela 7. Lista e grup-produkteve më të importuara nga Kosova, 2013

HS4	Përshkrimi	Në milionë Lekë	% totali
7204	Kthime dhe mbetje të rishkrirëshme prej gize dhe çeliku	2,335.3	38.0%
1101	Miell gruri dhe miell meslini;	1,173.6	19.1%
7306	Tuba, tubacione dhe profile prej gize dhe çeliku	331.8	5.4%
2202	Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	328.1	5.3%
7602	Mbetje dhe kthime alumini	228.5	3.7%
7304	Tuba, tubacione dhe profile të linjëzuara të përdorur për linja gazi dhe nafte	202.8	3.3%
3917	Tuba, pipa dhe zorra prej materialeve celulozike	202.2	3.3%
0701	Patate të freskëta apo të ftohta	181.2	2.9%
7210	Produkte petëzimi prej gize apo çeliku	119.6	1.9%
2203	Birrë bërë nga malti	106.0	1.7%
2302	Grundet, mbetjet nga sitja, bluarja e drithrave apo të	103.2	1.7%

	bimeve leguminoze		
9706	Antikat e një moshë më tepër se 100 vjet	100.6	1.6%
2517	Guralecat, zhavori për betonim, për metalizimin e rrugeve	67.8	1.1%
3921	Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike	52.2	0.8%
0901	Kafe, nëse është apo jo e pjekur apo e dekafezuar	39.3	0.6%
3923	Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike	38.8	0.6%
3925	Pajisjet e ndërtimit prej plastike	35.2	0.6%
3920	Pllaka, fleta, filma, prej plastike, jo celulare, jo të laminuara të pakombinuara me materiale të tjera	30.4	0.5%
2204	Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool	24.4	0.4%
2306	Bërsitë dhe mbetje të fituara nga ekstraktimi i yndyrnave vegjetale	21.0	0.3%
	Totali	5,722.1	93.1%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Përpunime të autorëve.

Duke përfunduar këtë pjesë përshkuese dhe analizuese të statistikave të shkëmbimeve tregtare, vihet re se dinamika e zhvillimit të eksporteve dhe importeve Shqipëri-Kosovë ka hyrë në një fazë maturimi për sa i përket flukseve tradicionale të shkëmbimeve tregtare. Tashmë tregtia, e nxitur nga zhvillimi i dy ekonomive si dhe nga politikat në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, po zhvillohet drejt diversifikimit gradual dhe në strukturë shfaqen elementë marxhinalë në terma volume, por me potencial dinamik për të sjellë flukse tregtare me vlerë të shtuar për të dy ekonomitë në të ardhmen. Këto elementë duhet të jenë në vëmendjen e politikëbërjes.

3.3. Vlerësimi i avantazheve krahasuese (RCA) mes dy vendeve

Në një përpjekje për të kuptuar dinamikën e flukseve tregtare aktuale, si dhe në përpjekje për të evidentuar ato fusha të shkëmbimit tregtar që në të ardhmen do ushqejnë rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe integritet ekonomik mes dy vendeve, u realizua analiza e avantazhet krahasuese të shfaqura. Në teorinë e tregtisë ndërkombëtare, avantazhet krahasuese mbeten një nga konceptet më të rëndësishme për të shpjeguar arsyet pse dhe cfarë produktesh vendet shkëmbejnë me njëri tjetrin. Indeksi i avantazheve krahasuese (RCA) përdor flukset tregtare mes vendeve për të vlerësuar sektorët ekonomikë në të cilët një vend shfaq avantazhe krahasuese në raport me një partner tregtar. Indeksi i avantazheve krahasuese në kontekstin bilateral të flukseve tregtare, vlerëson aftësinë eksportuese të një vendi kundrejt një vendi partner, duke e relativizuar kundrejt kërkesës globale.

Indeksi i avantazheve krahasuese bilaterale (BRCA) do tregojë epërsinë e vendit eksportues kundrejt eksporteve nga vende të tjera të botës në tregun e vendit partner tregtar. Ky indeks vlerësohet si vijon:

$$BRCA_{ij}^k = \frac{X_{ij}^k / X_{ij}}{X_{wj}^k / X_{wj}}$$

X_{ij}^k - Eksportet e produktit k të Kosovës (i) drejt Shqipërisë (j)

X_{ij} - Eksportet totale të Kosovës drejt Shqipërisë

X_{ej}^k - Eksportet e produktit k drejt Shqipërisë (j) nga gjithë bota (ë)

X_{ej} - Totali i eksportet të Shqipërisë

Indeksi është llogaritur për periudhën 2013-2018, duke përdorur të dhënat në nivelin HS2 të klasifikimit të mallrave në tregtinë ndërkombëtare. Të dhënat mbi totalin e eksporteve të dy vendeve janë marrë nga Institutet Kombëtare të Statistikës së Shqipërisë dhe Kosovës. Të dhënat e eksporteve nga Shqipëria drejt Kosovës në nivel produkti janë marrë nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.


Vlera të indeksit më të mëdha se 1 tregojnë për avantazhe krahasuese të Shqipërisë në tregun Kosovar. Më poshtë jepet një përmbledhje e rezultateve duke identifikuar sektorët me avantazhe krahasues më të larta. Rezultatet e plota të analizës janë paraqitur në Shtojcën 1.

Nga 99 seksione (HS 2 digit) indeksi i avantazheve krahasuese (BRCA) rezulton me vlerën më të madhe se 1 në 33 grup mallrash, duke identifikuar avantazhe krahasuese të Shqipërisë në 34% të seksioneve (ose sektorëve). Avantazhet krahasuese paraqiten të qëndrueshme në kohë. Nga analiza e vlerës së indeksit BRCA duket se Shqipëria ka humbur avantazhet krahasues në periudhën 2013-2018 për sektorë të rëndësishëm të eksporteve si zarzavatet, prodhimet e mishit si dhe veprat e artit.

Raportohen 24 seksione ose sektorë për të cilët vlera e indeksit është zero, përgjithësisht sektorë jo tradicionalë të eksporteve Shqiptare si psh eksportet e veglave muzikore, eksportet e metaleve të bakrit, nikel të përpunuar, avionët, orat etj.

Sektorët që raportohen të kenë avantazhe krahasues përfaqësojnë një potencial eksportues të ekonomive për tu shfrytëzuar. Produkte të industrisë bluajtëse (mielli, malti, dhe gjithë llojet e drithërave të bluajtura) kanë indeksin më të lartë të avantazheve krahasues, ndjekur nga mbetjet të industrisë ushqimore që eksportohen për ri-përdorim nga industri të tjera si ajo e rritjes së kafshëve.

Figura 11. Dinamika e indeksit të avantazheve krahasuese Shqipëri-Kosovë




Burimi: Përpunime të autorëve.

Grupi i dytë i sektorëve të analizuar kanë indeks në vlerën më të lartë se 1 në vitin 2018, ndërkohë që kanë qëndrueshmëri të avantazhit krahasues. Punimet artizanale si qilimat e endur, punimet e drurit për bastunë si dhe prodhimet e qelqit paraqesin avantazh krahasues. Këto shkëmbime tregtare ndikohen nga faktorë kulturorë dhe ndjenja kombëtare. Këto janë sektorë me fluks modest kur krahasohen me volumin total të eksporteve Shqiptare, por janë produkte që ndihmojnë mirëqënien e familjes duke gjeneruar të ardhura për artizanët dhe ndihmuar bizneset e vogla familjare.

Dy sektorë të rëndësishëm me avantazhe të ndjeshme krahasuese ngelen industria e përpunimit dhe prodhimit të mallrave prej plastikës dhe gomës si dhe përpunimi i skrapit në produkte të gizës dhe çelikut. Këto dy sektorë janë mjaft të rëndësishëm për flukset tregtare, duke përfaqësuar gati 50% të tyre. Prodhime të industrisë kimike që përdoren në pastrim si dhe ato të industrisë ushqimore (përgjithësisht prodhimin e pijeve) rezultojnë gjithashtu sektorë me avantazhe krahasuese.

Figura 12. Sektorët me avantazh krahasues bilateral në intervalin [10:1]



Burimi: Përpunime të autorëve.

Sektorë të tjerë të rëndësishëm për sa i përket avantazheve krahasuese që ka Shqipëria renditen agro-ushqimet, duke përfshirë prodhime nga drithërat dhe ëmbëlsirat, përgatitje prej zarzavateve dhe frutave, produkte bulmetore, mjalti dhe veza; industria e prodhimeve kimike si plehëruesit e tokës, produkte farmaceutike, mobiljeria dhe prodhime prej letre e kartoni, librat, revistat etj. Materiale ndërtimi, prodhime metalike për ndërtim (psh prodhime prej aluminit apo çelikut) vazhdojnë të ngelen në listën e produkteve me avantazhe krahasuese për Shqipërinë.

3.4. Analiza e shkëmbimeve tregtare ndër-sektoriale (Grubel-Lloyd Index)

Shpërndarja e flukseve tregtare dhe avantazhet krahasues nxjerrin në pah një fenomen që po formëzohet në tregtinë mes dy vendeve, shumë shpesh flukse tregtare janë inpute të ndërmjetme për industritë prodhuese të dy vendeve. Për të matur shkallën e lidhjes së sektorëve ekonomikë në një formë *input-output*, me shkëmbime tregtare ndërmjet industrive (ose firmave) indeksi i tregëtisë ndër-sektoriale u përllogarit duke përdorur Indeksine Grubel-

Lloyd. Ky indeks vlerëson shkallën e specializimit të industrive duke krijuar ekonomi të shkallës dhe eficiencë ekonomike. Në analizat tona u përdor indeksi klasik Grubel-Lloyd:

$$IIT_i = 1 - \frac{|X_i - M_i|}{X_i + M_i}$$

X_i - Eksportet e Shqipërisë në sektorin (i) drejt Kosovës

M_i - Importet e Kosovës në Shqipëri të produktit (i)

Llogaritjet u realizuan duke përdorur të dhënat e klasifikuara në HS4 digjit dhe HS 2 digjit. Analiza e rezultateve është paraqitur në nivelin HS2, duke identifikuar sektorët që po përpunë eficiencën e tyre duke përdorur shkëmbimet tregtare mes dy vendeve. Indeksi mund të shihet si një mundësi për të identifikuar zinxhir vlere ose klastera sektorialë.

Indeksi merr vlera në intervalin zero dhe 1, sa më afër vlerës 1 të jetë indeksi aq më e fortë është tregtia ndër-sektoriale. Rezultatet treguan se tregtia ndër-sektoriale është mjaft e ulët dhe vlera të indeksit më të mëdha se 0.3 janë vetëm 7% e indekseve të llogaritura.

Ndër sektorët që kanë indicie për specializim dhe integrim të zinxhirit të vlerës nëpërmjet shkëmbimeve ndër-sektoriale paraqiten agro-përpunimi, krijimi i produkteve ushqimore (ëmbëlsira) duke shkëmbyer lëndët e para si miellin, fruta, zarzavate etj. Në të njëjtën formë vihet re një integrim i zinxhirit të vlerës në disa nga nën-sektorët e prodhimit të kimikateve që përdoren në kozmetikë apo në pastrim. Prodhimi i artikujve të paketimit nga plastika dhe letra, shkëmbimi i lëndëve të drurit dhe mobilierisë duken gjithashtu shkëmbime tregtare të natyrës ndër-sektoriale.

Së fundmi në këtë hartëzim të sektorëve të ndërlidhur shfaqet dhe prodhimi i artikujve prej gize dhe çeliku, i cili bazohet tek importi i lëndëve të para nga Kosova (skrapit) dhe eksportimi i artikujve të përfunduar.

Tabela 8. Indeksi Grubel-Lloyd për shkallën e shkëmbimeve tregtare ndër-sektoriale

Përshkrimi HS2	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	0.18	0.11	0.58	0.38	0.34	0.38
Kakao dhe përgatitje kakao	0.39	0.33	0.45	0.87	0.97	0.67
Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave, etj.	0.28	0.34	0.35	0.54	0.34	0.36
Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	0.11	0.29	0.18	0.30	0.26	0.23
Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, përgatitje për parfumeri, kozmetikë, tualet, etj.	0.35	0.18	0.16	0.28	0.24	0.17
Sapuni, preparatet parëse, lubrifikues, qirinjte	0.59	0.51	0.34	0.21	0.16	0.14
Plastika dhe artikuj prej tyre	0.32	0.30	0.17	0.31	0.25	0.34

Druri dhe artikuj prej druri, qymyri i drurit	0.31	0.11	0.17	0.16	0.10	0.15
Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letrës dhe të kartonit	0.21	0.10	0.16	0.33	0.12	0.16
Artikuj prej gize dhe çeliku	0.15	0.30	0.22	0.15	0.24	0.34
Mobileritë, krevate, dyshekë, llamba dhe pajisjet e ndriçimit	0.23	0.33	0.21	0.21	0.22	0.14

Burimi: Përpunime të autorëve.

3.5. Potencialet e mëtejshme për shkëmbime tregtare midis dy vendeve

Vlerësimi i potencialit të shkëmbimeve tregtare është vlerësuar duke përdorur indeksin e Potencialeve Tregtare Indikative të Relativizuara (RITP). Indeksi vlerëson potencialin e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve duke krahasuar kapacitetin për të eksportuar të Shqipërisë me kërkesën e brendëshme të Kosovës për të njëjtin produkt (i).

$$RITP = [\min (EX, IM) - CT] / EX$$

EX - Eksportet totale të Shqipërisë për produktin (i)

IM - Importet totale të Kosovës për produktin (i)

CT- eksporti aktual i Shqipërisë në Kosovë për produktin (i)

Indeksi në formën e relativizuar merr vlerën nga 0% në 100%, një vlerë e vogël e RITP tregon për potenciale të ulëta dhe hapësira shkëmbime tregtare të shfrytëzuara. Rezultatet e analizës së RITP janë përmbledhur në figurën 13, në të cilën hapësira me ngjyrë është hapësira që përcakton potenciale të shkëmbimeve tregtare për tu shfrytëzuar nga shkëmbimet tregtare mes dy vendeve.


Në vija të përgjithshme, një raport i thjeshtë mes hapësirës së tregut të brendshëm në Kosovë të shfrytëzuar dhe atij të pashfrytëzuar, rezulton se mes dy vendeve ka hapësira të rriten dhe forcohen shkëmbimet tregtare.

Potencialet më të larta për rritjen e volumit të eksporteve vlerësohen të jenë mes sektorëve të tregtimit të produkteve tekstile të endura qofshin pëlhura, qilima apo dhe produkte të tjera (seksionet 53,52,59, 57), metalet bazë (75, 81) prodhime prej lëkure, makineri e pajisje, prodhime të industrisë kimike (31, 33, 30), produkte të mobilerisë, prodhime të plastikës dhe gomës, si dhe një sërë produktesh të agro-industrisë (23, 08, 06, 11, 07). Disa nga sektorët ku potencialet vlerësohen modeste janë prodhimet prej metali, prodhimet e lëkurës, prodhimet e detit (peshku), veshjet si dhe druri i përpunuar.

Kjo pjesë e analizës së statistikave përshkruese, e avantazheve krahasuese, e potencialeve tregtare dhe e tregtisë ndërdegësore, tregon se dy ekonomitë tona reflektojnë dobësitë e tyre të brendshme, si ekonomi të padiversifikuara nga pikëpamja e zhvillimit industrial. Për pasojë, volumet e shkëmbimeve janë të kufizuara në strukturë dhe të pastabilizuara nga pikëpamja dinamike. Nga ana tjetër, historiku i shkëmbimeve ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve tona është shumë i ri dhe nga këndvështrimi perspektiv, ato shfaqin potenciale që duhen shënjestruar nga politikat publike. Në veçanti, ne mendojmë se industritë që kanë një

zinxhir vleror të lidhur mes tyre, siç u identifikuan nga Indeksi GLL, duhen mbështetur me politika të përbashkëta stimuluese. Ballafaqimi i dy ekonomive me konkurrencën rajonale dhe globale kërkon përmirësime në gjithë zinxhirin vleror prandaj dhe duhet që politikat e mbështetjes së këtyre produkteve të jenë edhe më të unifikuara, si dhe sa më të koordinuara.

Figura 13. Vlerësimi i potencialeve të tregtisë Shqipëri-Kosovë



Burimi: Përpunime të autorëve.

Rritja e tregtisë midis dy vendeve me synimin që të shfrytëzohen potencialet ekzistuese, siç u evidentuan nga analiza e potencialeve tregtare, por edhe përmes krijimit të oportuniteteve të reja që do të vijnë si pasojë e ndryshimeve strukturore ekonomike përmes krijimit të industrive të reja, kërkojnë një anagazhim të vërtetë dhe serioz në reduktimin dhe eliminimin e plotë të të gjithë barrierave ekzistuese.

4. Barrierat jo-tarifore

Analiza e zhvillimit të marrdhënieve ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, e parë nga aspekti i barrierave teknike dhe jotarifore të lëvizjes së mallrave përmbledh problematikën në dy kategori kryesore: (1) çështje të lidhura me cilësinë, të tilla si njohja reciproke e certifikatave, infrastruktura jo e përshtatshme e testimeve, etj; dhe (2) çështje që lidhen me lehtësimin e tregtisë, të tilla si kompleksiteti i praktikave të zhdoganimeve, inspektimet e shpeshta, kohëzgjatja e pëmbjlljes së transaksioneve, etj., të cilat rrisin kostot dhe dëmtojnë konkurrueshmërinë e biznesve prodhuese në të dy anët e kufirit. Duhet theksuar se këto çështje nuk janë problem ekskluzivisht vetëm në praktikën tregtare midis dy vendeve, pasi ato ndeshen në të gjithë praktikën e tregtisë me jashtë në përgjithësi. Duke qenë se midis Shqipërisë dhe Kosovës ka një kuadër institucional më të favorizuar se me vendet e tjera, ne kemi përpjekur të diferencojmë këto praktika që përmendëm më sipër, në rastet kur ka të tilla.

Marrdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës janë të kornizuara si nga angazhimet e përbashkëta që dy vendet kanë ndërmarrë në kuadër të CEFTA, por edhe nga një numër gjithnjë në rritje marrëveshjesh dypalëshe që janë nënshkruar që prej vitit 2003, dhe që kanë marrë një hov më të madh pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 (raportohen gjithsej rreth 50 të tilla).

Ndërkohë që liberalizimi i tarifave doganore është arritur pa probleme, në shkëmbimet tregtare mes dy vendeve mbeten barrierat jotarifore dhe ato teknike. Ato kanë qenë dhe burime të konflikteve tregtare midis dy vendeve. Në thelb konfliktet nuk janë krijuar nga masa diskriminuese të zbatuara ekskluzivisht ndaj njëri-tjetrit, por ato janë zbatuar me të gjithë vendeve të tjera. Për shembull, vendosja e akcizës së diferencuar nga Shqipëria mbi prodhimet alkoolike (birrë, verë) për prodhuesit me kapacitet mbi 1 milion litër, në thelb synon të mbrojë prodhuesit vendas të cilët janë përgjithësisht më të vegjël se prodhuesit e huaj, prej të cilëve importohen sasi të mëdha në Shqipëri. Por, kjo masë e cila aplikohet nga Shqipëria ndaj të gjithë importeve të këtyre produkteve nga jashtë vendit, preku edhe tre subjekte prodhuese nga Kosova të cilët dispononin kapacitete prodhuese mbi 1 milion litër në vit. Duhet theksuar se praktika e aplikimit të një akcize të diferencuar për prodhuesit e vegjël është në linjë me praktikën e vendeve të BE-së¹ Marrëdhëniet me konflikte kulmuan në vitin 2013, kur u përfshinë edhe autoritetet shtetërore të dy vendeve². Për herë të parë që nga viti 1999, marrëdhëniet tregtare shënuan rënie në atë vit, për shkak se, bllokimi i qumështit shqiptar në tregjet e Kosovës u ndoq me bllokimin nga pala shqiptare të importit të mishit dhe të miellit

¹ Shiko:

https://ec.europa.eu/taxation_customs/sites/taxation/files/resources/documents/taxation/excise_duties/alcoholic_beverages/rates/excise_duties-part_i_alcohol_en.pdf

² Neni 23 i marrëveshjes së CEFTA-së lejon ndërmarrjen e masave mbrojtëse nga një vend anëtar i CEFTA-së ndaj një anëtar tjetër kur evidentohen raste “të sasisë së lartë të importit të një produkti i cili shkakton dëme serioze tek prodhuesi i vendit importues ose në rast që kjo sasi e lartë e importit shkakton pengesa serioze në ndonjë sektor të caktuar të ekonomisë të shtetit importues e që mund ta dëmtoj gjendjen ekonomike”. Mbi këtë nen dhe nenin 24 që rregullon procedurat vendosjes së barrierave, u mbështet vendimi i MTI-së së Kosovës në qershor 2012 për vendosjen e tarifës prej 35% në importet e çimentos në Kosovë, masë që ndikoi në eksportet shqiptare drejt Kosovës. Siç është interpretuar në mënyrë të plotë dhe të saktë nga Kursani (Kosova në Kontekst Rajonal - Marrëdhëniet Ekonomike dhe Tregtare, 2013), ky rasti gjen një justifikim të plotë si nga teoria e tregtisë ndërkombëtare ashtu dhe është e mbështetur në legjislacionin e organizatave si CEFTA.

nga Kosova. Më tej, konflikti vijoi nga pala e Kosovës me bllokimin e materialeve të ndërtimit. Gjatë verës së vitit 2013, qeveria e Kosovës zhvendosi pikat e zhdoganimit të mallrave, duke krijuar probleme për eksportuesit e Shqipërisë.

Me qëllim minimizimin deri në eliminimin e konflikteve tregtare që burojnë nga pengesat teknike dhe barrierat jo-tarifore në transaksionet midis dy vendeve, në vitin 2015 është nënshkruar dhe Protokollin “Për zbatimin e Marrëveshjes kuadër për Bashkëpunimin në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës” nënshkruar dhe hyrë në fuqi në 23.03.2015.

Protokollin synon heqjen e të gjitha barrierave jo-tarifore mes të dy vendeve, me qëllim rritjen e shkëmbimeve tregtare). Specifikisht ky protokoll ndikon në:

- Fushën e rregullave teknike: Harmonizimin e rregullave teknike për produktet me interes reciprok.
- Fushën e standartizimeve: Përshtatjen e standarteve me objektiv harmonizimin, njohjen reciproke, ose referimin në standardet ndërkombëtare sipas rastit.
- Fushën e akreditimeve: Ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave konkrete për përshtatjen e skemave të akreditimit, harmonizimit të legjislacionit për akreditimin dhe njohjen e kompetencës teknike të vlerësuesve/ekspertëve teknikë të miratuar nga të dy palët.
- Fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinare: Njohja e rezultateve të testeve dhe analizave të kryera nga laboratorët e akredituar në të dyja vendet tona
- Institucionalizimin e punës së grupeve teknike të krijuar nga marrëveshja kuadër. Për të lejuar zbatimin e aktiviteteve në fushën e standardizimit, akreditimit dhe rregullave teknike dhe atë të sigurisë ushqimore dhe veterinare, ky protokoll miratoi funksionet e tri grupeve të përbashkëta të punës të krijuara tashmë.

Diskutimet me grupet e interesit të zhvilluara në kuadër të këtij studimi, evidentuan se progresi është shumë i ngadaltë dhe se burokracitë në tregtinë midis dy vendeve nuk kanë njohur pothuaj asnjë lehtësim. Grupi Ndërinstitucional i Koordinimit të Politikës Tregtare dhe Lehtësimit të Tregtisë ka realizuar një studim mbi vlerësimin e barrierave teknike në tregtinë e produkteve bujqësore (kryer nga një organizatë studimore lokale – IP3³). Në këtë studim trajtohet problematika që prek gjithë nën-sektorët bujqësorë të eksportit, si dhe probleme/barriera për nën-sektorë të veçantë të eksportit bujqësor. Më konkretisht janë trajtuar problemet që ndeshen në fusha të tilla si transparenca dhe informacioni, kërkesa dokumentare dhe dokumentet elektronike, kontrolli në kufi dhe infrastruktura e cilësisë (vlerësimit të konformitetit). Dokumenti ka dhënë një numër sugjerimesh të cilat nëse do të shndërrohen në akte juridike, do të lehtësonin shumë kryerjen e transaksioneve nga eksportuesit dhe importuesit nga Kosova. Çështjet që lidhen me skanimet dhe tarifatat respektive, kontrollin fizik

³ <http://www.tregtia.gov.al/images/pdf/Inventari-i-tarifave-dhe-pagesave-.pdf>

në kufi, kërkesat dokumentare të tepërta dhe që përsëriten në mënyrë të panevojshme por që krijojnë kosto, etj., i janë propozuar Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë që të hiqen, si dhe të realizohen përmirësime infrastrukturore dhe të menaxhimit në mënyrë që ato të mbahen në cakun e nevojshëm të garantimit të interesit publik, por pa prodhuar kosto të panevojshme për operatorët ekonomik. Gjetjet nga pyetësi i zbatuar me biznesin në kuadër të këtij projekti, kanë konfirmuar problematikat e raportit të Grupit Ndërinstitucional.

Sa i takon rregullave të origjinës, të gjithë vendet e CEFTA-s janë nënshkruese dhe zbatuese të Marrëveshjes Rajonale Pan Euro-Mesdhetare (PEM), në të cilën Kosova nuk ka aderuar ende. Siç u nënvizua dhe në takimin me ekspertët e doganave shqiptare që punojnë në këtë fushë, mungesa e kësaj marrëveshje ka ndikime në kumulimin e vlerës së mallrave me destinacion vendet jashtë zonës së Bashkimit Europian, veçanërisht me vendet e EFTA-s. Ky problem ka krijuar vështirësi në lëshimin e Certifikatës Euro 1.

Lidhur me masat sanitare dhe fitosanitare, që janë një tjetër pengesë: duke qenë se ngarkesat për eksport realizohen gjatë natës, kur inspektorët përgjegjës nuk janë në punë, rekomandohet që kontrolli dokumentar ti delegohet nëpunësve të doganave. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të tyre në këtë fushë do lehtësonte zbatimin e kësaj mase. Në afat më të gjatë, të dy vendet duhet të mundësojnë forcimin e besimit midis trupave të certifikimit dhe inspektimit, pasi mungesa e besimit është shkaku që autoritetet e vendeve pritëse të mallit kryejnë testime të tjera mikrobiologjike (për mallrat ushqimore dhe ato me origjinë bujqësore) pasi rezultojnë se nuk i besojnë analizave laboratorike të kryera në vendin tjetër. Aktualisht, praktika ndërkombëtare zbaton sistemet e teknologjisë së IT (ePHYTO) që janë certifikatat elektronike fitosanitare. Sekretariati i Konventës Ndërkombëtare për Mbrotjen e Bimëve shërben si një “hub” duke mbajtur një sistem të centralizuar të lëshimit të certifikatave nga secili vend. Kjo kërkon që autoritetet e dy vendeve duhet të investojnë me përparësi në një projekt të tillë, fillimisht midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe që më vonë mund të shtrihet me të gjithë vendet e tjera. Po kështu, meqenëse në disa raste kërkesat dhe rregullat mbi nivelet e pesticideve apo karakteristikat e tjera të vetive kimike të produkteve janë të ndryshme me ato të vendeve të tjera, përfshirë edhe të Kosovës, është e nevojshme që këto kërkesa të jenë të harmonizuara.

Lidhur me procedurat e shërbimit doganor, përfaqësuesit e biznesit vënë në dukje se:

1. Pagesat e skanimit janë tepër të larta dhe për një shërbim që nuk kryhet. Praktika ndërkombëtare (rregullimet e OBT-së) kërkon që skanimi të kryhet mbi bazën e riskut, duke zëvendësuar praktikën e kontrollit fizik, ndërsa në rastin e Shqipërisë kjo është shndërruar në praktikën bazike, duke ja nënshtruar këtë proces të gjitha ngarkesave. Është një masë e palogjikshme dhe që buron nga marrëveshja e koncensionit, por kjo praktikë duhet rishikuar në themel, duke u aplikuar vetëm për ngarkesat me risk të lartë. Tarifa duhet eliminuar për ngarkesat që nuk i nënshtrohen skanimit, pasi rregullimet e OBT-së kërkojnë që pagesat e një tarife duhet të lidhen me kryerjen e një shërbimi. Së fundmi, praktika e pagesave duhet lehtësuar, pasi bizneseve ju kërkohej të shkojnë në një degë banke, larg pikave të doganës dhe të kryejnë pagesën kundrejt një tarifë prej 1 Euro për çdo 1 mijë lekë.

2. Praktika e zhdoganimeve është shumë burokratike dhe megjithëse dokumentet e zhdoganimeve janë në sistemin ASYCUDA, zhdoganimi kryhet kundrejt paraqitjes së gjithë dokumenteve në *hard copy*. Disa dokumente fiskale dhe Euro 1 kërkohen të jenë origjinale për [do ngarkesë. Sipas një vlerësimi të kryer nga një projekt⁴ i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), aplikimi i procedurave doganore në linjë me kodin doganor evropian duke filluar nga viti 2019, synimi i lehtësimit të praktikës doganore nëpërmjet menaxhimit të riskut, mund të rezultojë në shtim të burokracisë administrative nëse autoritetet doganore shqiptare nuk shfrytëzojnë sistemet e ofruara të informacionit në menaxhimin e riskut. Studimi jep rekomandime shumë specifike si për reformimin e praktikës së zhdoganimeve ashtu dhe rishikimin e programit ASYCUDA që është në zbatim.
3. Shpesh vonesat vijnë si rezultat i kufizimeve në kapacitet të infrastrukturës, e cila duhet të vazhdojë të përmirësohet dhe modernizohet.

Ndërkohë, kryerja e transaksioneve tregtare sigurisht që bart dhe kosto shtesë dhe që janë pjesë e natyrshme e çdo aktiviteti tregtar të import-eksportit. Dërgimi i produktit që nga vendi i prodhimit e deri në destinacionin final tek përdoruesi në vendin e importuesit, shoqërohet me një sërë kostosh shtesë mbi vlerën e produktit. Kur këto kosto janë të larta, mundet që konkurrueshmëria e tyre të goditet dhe prodhuesi të humbasë tregun e shitjeve. Për pasojë, vendet tona të rajonit janë të angazhuara (dhe të mbështetura nga donatorët) në programe specifike të lehtësimit të tregtisë. Në kuadër të këtij programi, është bërë një vlerësim⁵ i detajuar të këtyre kostove, nga ku rezulton se Shqipëria:

1. ka një sistem të thjeshtë të Tarifave dhe Pagesave. Ai përbëhet nga tarifa e pagesa të inspektimit, përpunimit dokumentar dhe shërbimit doganor; tarifa të mirëmbajtjes dhe magazinimit të mallit; tarifa të licencës së importit; taksa të infrastrukturës së transportit; dhe taksa të tjera. Sistemi nuk përmban taksa mbi transaksionet në valutë të huaj, taksë për vulën, tarifa të faturës konsullore dhe taksa dhe pagesa për kategori produktesh të ndjeshme.
2. Disa herë nuk zbaton rregullin e trajtimit kombëtar, i cili kërkon trajtim të njëjtë të biznesit të huaj dhe atij vendas. Mosrespektimi i trajtimit kombëtar është i qartë në rastin e importit të shërbimeve, të tarifave për lejet për shumëzimin e materialit mbjellës bimor, testimin e bimëve të kultivuara, regjistrimin e specieve ose varieteteve, etj.
3. Në disa raste tarifat dhe pagesat e paguara nga biznesi janë qartësisht dhe dukshëm më të larta se kostoja, si në rastin e Çertifikatës Euro 1, Formularit TC 31, Çertifikatës së Garancisë, Formularit Forma A, etj., për të cilat në dokumentet e Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave deklarohen diferenca mes koston dhe tarifës.

⁴ GIZ (2018) Business Process Analysis (BPA) Study - Republic of Albania Trade Procedures

⁵ *Inventari i tarifave dhe pagesave të zbatueshme për importet dhe eksportet shqiptare:*
<http://www.tregtia.gov.al/images/pdf/Inventari-i-tarifave-dhe-pagesave-.pdf>

Grupi Ndërinstitucional i Koordinimit të Politikës Tregtare dhe Lehtësimit të Tregtisë, i cili mbas vlerësimit të kostos së barrierave jo-tarifore ka sugjeruar të iniciohet një grup ndër-institucional për rishikimin e tarifave dhe pagesave për t'i sjellë ato në linjë me rregullat e tregtisë ndërkombëtare bazuar në praktikën më të mirë në fushën e tarifave dhe pagesave.

Duke përmbyllur këtë pjesë të analizës së barrierave jotarifore dhe teknike në tregtinë midis Shqipërisë dhe Kosovës, mund të theksohet se *efekti kufi* në tregtinë midis dy vendeve, materializuar në një numër i lartë pengesash, vazhdon të ndikojë negativisht në zgjerimin e tregtisë. Po kështu, kostot e larta të kalimit të kufirit që shoqërojnë transaksionet, që nga kostot e transportit, shfrytëzimit të infrastrukturës dhe lehtësive tregtare, të praktikës që lidhet me procesin e zhdoganimit, trajtimet e diferencuara në operatorëve ekonomik veçanërisht në tregtinë e shërbimeve (si për shembull, sigurimet, shërbimet mjeksore, etj), përfshi dhe tregtinë e paligjshme që raportohet, bëjnë që bizneset të humbasin konkurrueshmërinë e tyre në treg dhe të dekurajohen në përpjekjet për zgjerim tregu. Vlerësimet e kryera në studimet të hershme mbi efektin e barrierave teknike jo-tarifore nënvizojnë se ato mund të përkthehen të barabarta me efektin e një tarife doganore mbi 10%. Prandaj rishikimi i tyre në mënyrë që shkohet drejt parimit të tarifës për mbulim kostosh dhe eliminimin e burokracisë në tregtinë ndërkufitare, duhet të jenë një çështje prioritare.

5. Zbatimi i marrëveshjeve

Zhvillimi në tërësi i marrëdhënieve tregtare midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të botës realizohet në kuadër të sistemit të tregtisë botërore (OBT) ku Shqipëria merr pjesë si anëtare që prej vitit 2001, si dhe të tregtisë rajonale, ku Shqipëria zbaton Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me vendet anëtare të Bashkimit Europian që prej vitit 2009 dhe që prej vitit 2006 edhe si anëtare e CEFTA, ku bën pjesë edhe Kosova. Me qëllim lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë dhe thellimin e bashkëpunimit ekonomik, tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës, përveç këtij kuadri institucional, veprojnë edhe një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh dhe memorandumesh mirëkuptimi dypalëshe që janë nënshkruar gjatë këtyre viteve. Disa tipe marrëveshjesh janë marrëveshje të cilat vendi ynë i ka nënshkruar edhe me shumë vende të tjera të botës me të cilat zhvillon tregtinë dhe investimet. Në vijim po shqyrtojmë shkurt ecurinë dhe stadin e zbatimit të disa prej marrëveshjeve kryesore në fushën e ekonomisë dhe tregtisë, të raportuara nga institucionet publike dhe të hulumtuara nga puna kërkimore.

1. “Marrëveshja e nxitjes dhe mbrojtjes së ndërsjellë të investimeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”, nënshkruar më 3 maj 2016. (Marrëveshje kuadër e nënshkruar me shumë vende të botës).

Marrëveshja synon të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe nxitjen e investimeve direkte në Shqipëri dhe në Kosovë. Marrëveshja u jep investitorëve të secilit vend, siguri dhe garanci që investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë, në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare.

Statusi: Pala e Shqipërisë i ka përfunduar procedurat e saj të brendshme të miratimit dhe e ka njoftuar palën e Kosovës. Pritet nga kjo e fundit njoftimi zyrtar nëpërmjet kanaleve diplo-

matike mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

2. “Marrëveshja kuadër për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë”, nënshkruar më 11.01.2014 dhe hyrë në fuqi më 11 Mars 2015, dhe Protokoll i “Për zbatimin e Marrëveshjes kuadër për Bashkëpunimin në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës” nënshkruar më dhe hyrë në fuqi në 23.03.2015.

Protokoll synon heqjen e të gjitha barrierave jo-tarifore mes të dy vendeve, me qëllim rritjen e shkëmbimeve tregtare).

- Në fushën e rregullave teknike: Harmonizimin e rregullave teknike për produktet me interes reciprok.
- Në fushën e standardizimeve: Përshtatjen e standardeve me objektiv harmonizimin, njohjen reciproke, ose referimin në standardet ndërkombëtare sipas rastit.
- Në fushën e akreditimeve: Ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave konkrete për përshtatjen e skemave të akreditimit, harmonizimit të legjislacionit për akreditimin dhe njohjen e kompetencës teknike të vlerësuesve/ekspertëve teknikë të miratuar nga të dy palët.
- Në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarë: Njohja e rezultateve të testeve dhe analizave të kryera nga laboratorët e akredituar në të dyja vendet tona
- Institucionalizimi i punës së grupeve teknike të krijuar nga marrëveshja kuadër. Për të lejuar zbatimin e aktiviteteve në fushën e standardizimit, akreditimit dhe rregullave teknike dhe atë të sigurisë ushqimore dhe veterinarë, ky protokoll miraton funksionet e tri grupeve të përbashkëta të punës të krijuara tashmë.

Statusi: Siç u analizua në seksionin që i kushtohet barrierave jotarifore dhe teknike, procesi i zbatimit është shumë i ngadaltë, i shoqëruar me një nivel të lartë mosbesimi reciprok midis institucioneve të të dy palëve.

3. “Marrëveshja për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet dhe mbi të ardhurat mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”, nënshkruar më 28.3.2014 dhe hyrë në fuqi më 11 Mars 2015 dhe me efekte financiare nga 1 Janari 2016.

Statusi: Kjo marrëveshje rezulton që është në zbatim, por megjithatë raportohen raste ku nuk zbatohet e për rrjedhojë kërkon monitorim.

4. “Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kosovare të Standardizimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës”, nënshkruar më 31.7.2015, hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.

Marrëveshja synon lehtësimin e procedurave të punës për adoptimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si standard të Kosovës.

Statusi: Janë plotësuar 100% kërkesat për standardet me qëllim harmonizimin e standardeve të Kosovës me ato ndërkombëtare në fuqi.

5. “Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim në fushën e metrologjisë” mes Departamentit të Metrologjisë së Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të Shqipërisë, nënshkruar më 26.11.2012.

Statusi: Rezulton e zbatuar plotësisht.

6. “Memorandumi i Bashkëpunimit për bashkëpunim në fushën e patentave dhe markave” midis Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Pronësisë Industriale të Republikës së Kosovës”, nënshkruar dhe hyrë në fuqi në datë 07.12.2011.

Memorandumi parashikon fushat specifike të bashkëpunimit mes dy institucioneve homologe, me synim shkëmbimin e ndërsjellët të eksperiencës, informacionit dhe publikimeve në fushën e Pronësisë Industriale, dhënien e ndihmës reciproke në përmirësimin dhe implementimin e programeve kompjuterike dhe bazave të të dhënave që lidhen me procedurat e regjistrimit të objekteve të Pronësisë Industriale, bashkëpunimin reciprok në përmirësimin e legjislacionit dhe përmbushjen e standardeve të vendosura nga organizmat ndërkombëtare të fushës si dhe organizimin e aktiviteteve trajnuese dypalëshe.

Statusi: Janë organizuar takime të përbashkëta në kuadër të koordinimit të fushave të bashkëpunimit, por rezulton ende e pazbatuar.

7. “Marrëveshje për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës nënshkruar më 06.10.2009, hyrë në fuqi me 1.3.2010.

Palët nëpërmjet autoriteteve të tyre doganore do të mundësojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë në mënyrë që të sigurohet zbatimi i saktë i legjislacionit doganor; me qëllim parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve të legjislacionit doganor; në lidhje me njoftimin e dokumenteve me qëllim zbatimin e legjislacionit doganor. Ndihma do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e kërkuar të palës Kontraktuese dhe brenda kompetencave dhe burimeve në dispozicion të autoritetit doganor të kërkuar.

Statusi: Në vijim të kësaj marrëveshje, është realizuar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Doganës së Republikës së Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të RSH nr.14956 dt.19.06.2014. Nuk rezultojnë hapa të mëtejshëm.

8. “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e PPKK Borje-Gllloboçicë, Orgjost (Kukës)-Orçush (Dragash) dhe Shishtavec (Kukës)-Krusheve (Dragash) dhe protokolleve të përbashkëta të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këto Pika të Kalimit Kufitar, të miratuar në parim me VKM Nr. 187 datë 13.10.2010, me qëllimin për të lehtësuar kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar të dy vendeve.

Statusi: Këto Pika të Kalimit Kufitar janë marrë në dorëzim nga Dogana dhe Policia por ende nuk kryejnë veprime doganore.

9. Protokollet e fazës së parë dhe të dytë të Projektit SEED (nënshkruar më 11 janar 2011 faza e parë dhe 18 qershor 2012 faza e dytë) mbi Shkëmbimin Elektronik të të Dhënave ndërmjet Administratave Doganore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Statusi: Ky shkëmbim paraprak elektronik i të dhënave midis dy administratave doganore vazhdon rregullisht dhe ka ndikuar ndjeshëm në reduktimin e afateve kohore për kryerjen e procedurave doganore në kufi si dhe ka krijuar efekte të parandalimit të shkeljeve doganore apo tentativave për kontrabandë dhe trafike të ndryshme të mallrave. Pikat kontaktit në Drejtorinë e Informacionit janë aktive dhe bëjnë të mundur shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejtë për raste sensitive me Kosovën dhe anasjelltas në kudër të informalitetit dhe luftës së evazionit fiskal nga të dyja palët. Për të gjitha rastet e kërkuara raportohet se është vepruar shumë shpejt duke dhënë asistencë dhe përgjigje brenda një kohe të shkurtër si nga të dy administratat.

10. “Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Doganës së Republikës së Kosovës për projektin e rehabilitimit të Pikës së Kalimit Kufitar Morinë-Kukës-Vërnice”, nënshkruar më 19.06.2014, në Tiranë.

Statusi: Ceremonia e hapjes së Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar në Morinë-Vërnice u zhvillua më 24.07.2018. Ndërkohë është ngritur Grupi i Punës për hartimin e projekt marrëveshjes/protokollit me Doganën e Kosovës për vendosje në objektin e Morinës, hartimin e manualit për proceset e punës dhe procedurave standarde të funksionimit.

11. “Marrëveshja për bashkëpunim midis Ministrive të Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës”, nënshkruar më 23.03.2015 hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

Statusi: Marrëveshja synon që Palët të bashkëpunojnë për përmirësimin e kushteve të të bërit biznes në të dy vendet, duke përmirësuar procedurat fiskale dhe doganore dhe, për sa është e mundur, përafruar nivelet taksave. Memorandumi ka për qëllim të bashkërendojë punën e administratave fiskale dhe doganore, si dhe organeve përgjegjëse për politikën fiskale për të ngushtuar dallimet që ekzistojnë në ambientin ekonomik në secilin vend. Rezulton ende e pazbatuar.

12. “Memorandum Mirëkuptimi mes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Sipërmarrjeve në Kosovë”, nënshkruar dhe hyrë në fuqi në 27.11.2017.

Statusi: Nuk raportohen zhvillime për zbatimin e kësaj marrëveshje.

13. “Marrëveshje mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension” ratifikuar me Ligj Nr. 20/2018, nënshkruar në 27.11.2017.

Statusi: Marrëveshja i jep mundësinë shqiptarëve në të dy anët e kufirit të mos humbasin periudhat e tyre kontributive, pavarësisht se ku punojnë, në Shqipëri apo Kosovë. Dispozitat e

kësaj marrëveshjeje zbatohen vetëm për vërtetim të ndërsjellë, të periudhave të sigurimit, me qëllim plotësimin e kushteve për arritjen e së drejtës për pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit dhe pensionin familjar. Nuk raportohen hapa të mëtejshëm drejt zbatimit.

14. “Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës për krijimin e qendrës së përbashkët trajnuese”, nënshkruar në Prishtinë, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 3.6.2016.

Statusi: Marrëveshja ka si qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve fiskale të Shqipërisë e Kosovës dhe shkëmbimin e përvojave të të dy anëve të kufirit.

15. “Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës në fushën e hetimeve administrative, tatimore dhe doganore”, nënshkruar në Prishtinë, më 3.6.2016.

Statusi: Marrëveshja rregullon bashkëpunimin në fushën e hetimeve penale dhe administrative mes institucioneve të fushës së tatimeve dhe doganave të autoriteteve të të dy vendeve. Ajo harmonizon dhe çështjen e këmbimit të informacionit mes dy palëve, me qëllim pasurimin e proceseve hetimore, si dhe rritjen e kapaciteteve të hetimit në të dy krahë. Marrëveshja rezulton pjesërisht e zbatuar, por raportohet vullnet institucional dhe ecuri të mirë të praktikave që kanë filluar tashmë.

16. Protokolli për Kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë-Vërmicë, në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Pejë, 26.11.2018.

Statusi: Zbatuar plotësisht.

17. Protokolli ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, për njohjen bilaterale dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinare dhe fito sanitare që do të shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produktet bimërore gjatë importit, eksportit dhe transitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, nënshkruar në Pejë, 26.11.2018.

Statusi: Ky protokoll rezulton ende i pazbatuar.

18. Porti i Durrësit dhe Porto Romano bëhen pika doganore të Kosovës.

Statusi: Zyra Doganore e Republikës së Kosovës tashmë do të mund të kryejë procedura doganore në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano, për zhdoganimin e mallrave që kanë destinacion final përdorimi Republikën e Kosovës. Për këtë qëllim, zyrtarët/oficerët doganorë të doganës së Kosovës kryejnë në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano procedurat e kontrollit/ekzaminimit fizik të mallrave. Rezulton e zbatuar.

Duke përmbledhur analizën e këtij seksioni, mund të shikohet se ka një vullnet politik të fortë për të plotësuar kuadrin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve. Numri i lartë i marrëveshjeve të nënshkruara si dhe takimet e përbashkëta periodike të dy qeverive,

përbëjnë një bazë të fortë për inkurajimin e tregtisë dhe investimeve midis dy vendeve. Megjithatë, një sërë problemesh janë evidentuar nga sipërmarrjet nga të dy anët e kufirit, gjë që dëshmon se në nivelet më të ulëta të institucioneve zbatuese, ky vullnet i lartë politik nuk përkethehet aq sa duhet në zbatimin praktik, sidomos për marrëveshjet më të rëndësishme. Si rezultat, qasja ndaj integritit ekonomik dypalësh ka patur më shumë një natyrë sporadike dhe *ad hoc*, e udhëhequr nga prioritetet e evidentuara nga momenti dhe jo një qasje e strukturuar, me një axhendë pune dhe plane veprimesh të mirëstudiuar, sidomos për fazën zbatuese.

Nëse interesi i përbashkët është një harmonizim i plotë i politikave, rregullave dhe standardeve, një koordinim më i mirë në veprimtarinë e institucioneve është një domosdoshmëri. Për pasojë, krijimi i një njësie koordinuese me autoritet të lartë politik nga të dyja palët, mund të shërbente edhe më mirë këtij qëllimi. Krijimi i një ekipi të përbashkët të formalizuar, me një bashkëkryesi prej dy personalitetesh të larta politike nga të dy anët e kufirit, mund të ishte një hap më rëndësor për ti dhënë përmbajtje reale këtij procesi. E ngarkuar posaçërisht me hartimin e axhendës dhe planeve të veprimit dhe menaxhimin e proceseve ligjore dhe teknike në harmonizimin e politikave dhe praktikave, kjo njësi do të koordinonte më mirë dhe në mënyrë më të strukturuar të gjithë punën në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ajo do të shërbente edhe si një sekretariat teknik për përgatitjen e mbledhjeve të përbashkëta të qeverive të të dy vendeve në mënyrë që planet të veprimit që miratohen, të ndiqen me rigorozitet për të siguruar zbatueshmërinë efektive të tyre.

Është me rëndësi të nënvizohet se çdo eksperiencë e fituar dhe çdo përparim që shënohet në këtë proces integrimi dypalësh, mund të shërbejë edhe një zbatim më të mirë të CEFTA-s dhe nismave rajonale për krijimin e zonës ekonomike në Ballkan, një projekt me rëndësi për të dy vendet. Çdo praktikë e re lehtësuese në tregtinë midis dy vendeve mund të zbatohet në mënyrë të pavarur nga secili vend edhe në shkëmbimet tregtare me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë. Integrimi dypalësh i shërben integritit rajonal, njësoj si ky i fundit i shërben integritit evropian. Pra, nuk duhen parë si procese bllokuese dhe përjashtuese, por si blloqe ndërtuese të një sistemi të bashkëpunimit ekonomik e tregtar më të gjerë rajonal dhe evropian për të dy ekonomitë, drejt integritit në një të vetme. Ndërkohë, një harmonizim i plotë i politikave zhvillimore midis dy vendeve tona, ka si synim të përdorë në mënyrë më produktive dhe eficiente burimet ekonomike, duke krijuar sektorë konkurrues që mund t'i bëjnë ballë ekonomive të tjera.

6. Përfundime dhe rekomandime

1. Hapja ekonomike bashkë me një kuadër liberalizues dhe marrëveshesh të nënshkruara midis Shqipërisë dhe Kosovës, kanë bërë që shkëmbimet tregtare midis dy vendeve të jenë intensifikuar ndjeshëm dhe duke u rritur me norma vjetore mjaft të larta gjatë këtij 5-vjeçari. Volumi i shkëmbimeve tregtare mes tyre ka njohur rritje të vazhdueshme duke konsoliduar flukset tregtare. Megjithatë, kjo dinamikë vuan nga brishtësia e dy ekonomive dhe nga përqëndrimi në pak sektorë të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar. Gjithashtu, dy ekonomitë kanë krijuar shumë pak hapësira për konsolidim të zinxhirit të vlerës dhe bashkëpunimin ndërsektoral. Sipas analizës dhe modeleve ekonometrike, midis dy vende rezultojnë ende potenciale të pashfrytëzuara në një masë të madhe sektorësh, deri në dyfishim të flukseve ekzistuese. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për tregtinë ndër-sektoriale.

Megjithatë është e diskutueshme aftësia e ekonomisë shqiptare për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij trendi pozitiv në afatgjatë. Aftësia e dy ekonomive për të akumuluar vlerë dhe për të eksportuar në rajon duket e ulët dhe në fazat e para të zhvillimit. Përqëndrimi i strukturës së eksporteve në pak produkte/sektorë është një faktor tjetër që rrit vulnerabilitetin e qëndrueshmërisë së eksporteve. Identifikimi i potencialeve tregtare dhe vlerës së shtuar nga tregtia ndërdegësore që janë realizuar nga ky studim, kanë si qëllim që të udhëheqin politikat zhvillimore mbështetëse nga të dy qeveritë respektive.

Në këtë drejtim, struktura e ngjashme e dy ekonomive është faktor nxitës për bashkëpunimin në nivel sektori duke nxitur konkurrueshmërinë e bazuar në ekonominë e shkallës dhe specializim. Megjithatë ky integrim mes ekonomive duket të jetë fillestar dhe pak i ndikuar nga politikat dhe përpjekjet për të krijuar një hapësirë ekonomike të përbashkët. Komuniteti i biznesit ankohet dhe shprehet se dy vendet nuk kanë akoma një qasje unike strategjike afatgjatë në këtë drejtim. Dy vendet nuk kanë identifikuar sektorë strategjike si bazë e nxitjes së shkëmbimeve ekonomike dhe konkurrueshmërisë rajonale, dhe si rezultat marrëveshjet e nënshkruara nuk kanë pasur natyrë specifike dhe potenciuese të avantazheve krahasuese mes dy vendeve.

2. Disa nga sektorët që manifestojnë normë të lartë rritje të eksporteve drejt Kosovës janë produktet vegjetale, produktet e industrisë së letrës dhe kartonit, produktet minerale si dhe prodhime të industrisë kimike. Të rëndësishme në strukturën e eksporteve shfaqen prodhimet vendase të drurit/mobilierisë, prodhimet bujqësore ndër të cilat eksportin kryesor e zënë domatet, agrumet, pjepërat, shalqin dhe kastravecet. Importet kryesore të Shqipërisë nga Kosova përfaqësohen nga metalet të cilat sillen në Shqipëri për ri-përpunim (skrap hekuri dhe alumini përgjithësisht). Ky element importi është një formë e tregtisë ndër-sektoriale, pasi metalet mbasi përpunohen ri-eksportohen në Kosovë, si shufra hekuri, profile dhe forma të tjera të metaleve të përpunuara të vlefshme për sektorin e ndërtimit.

Dinamika e zhvillimit të tregtisë, që ndjek avantazhet krahasuese të ekonomive si dhe zhvillimet në tregjet e brendshme duhet të jetë në vëmendjen e politikëbërjes. Lehtësimet e tregëtisë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të lehtësojnë krijimin e vlerës në sektorët e përpunimit të letrës dhe plastikës, prodhimeve të lëndëve kimike, ushqimeve të përpunuara,

produkteve bujqësore apo dhe bashkëpunimit të industrisë tekstile dhe prodhimit të produkteve të lëkurës.

Gjithashtu, dinamika e shkëmbimeve ekonomike, të përfaqësuara nga shkëmbimet tregtare, turizmi dhe investimet e huaja mes dy vendeve, japin sinjale pozitive për domosdoshmërinë e thellimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit ekonomik.

3. Axhenda e punës së përbashkët të dy qeverive duhet të përfshijë liberalizimin e plotë të ofrimit të shërbimeve që janë thelbësore për të mbështetur aktivitetin ekonomik, duke njohur në mënyrë reciproke lejet, patentat, licensat, diplomat apo çdo dokument tjetër me natyrë certifikuese të një kompetence që një subjekt, disponon për kryerjen e një shërbimi. Një hap domethënë në këtë drejtim do të ishte njohja e të drejtës së themelimit: domethënë, nëse një biznes është i regjistruar në njërin nga vendet tona, atij ti njëhej e drejta e operimit dhe në vendin tjetër pa qenë e nevojshme një procedurë shtesë regjistrimi. Kjo pastaj do të diktojë nevojën e ndërtimit të sistemeve të përbashkëta të monitorimit të funksionimit të tregjeve dhe garantimit të respektimit të detyrimeve ligjore në fushën e standarteve dhe aspekteve të natyrës financiare dhe fiskale.

Përfaqësues të bizneseve kanë theksuar se shpesh kuadri i përgjithshëm i marëveshjeve nuk ndihmon agjentët ekonomikë të materializojnë përfitime për shkak se mikro - faktorët nuk reflektohen në marrëveshje apo në mënyrën si ato zbatohen. Edhe raste të barrierave jo-tarifore të hasura mes dy vendeve janë shpesh mungesë e koordinimit dypalësh në zbatim të marrëveshjeve me procedurat administrative.

4. Edhe pse tashmë ka grupe pune të krijuara për të adresuar tematika specifike, mbetet ende nevoja që të kalohet nga kjo qasje ad hoc dhe spontane, drejt një qasje më sistematike, me struktura të dedikuara për të materializuar vullnetin politik edhe në nivele më operacionale. Si një hap i parë do të shërbente krijimi i një njësie të përbashkët në nivel teknik por me bashkëdrejtim me personalitete të niveleve më të larta politike, për të trajtuar industri-për-industri modalitetet e kërkuara për të kaluar drejt këtij modeli të ri të operimit të biznesve. Prej kësaj pune do të ndërtohej një skedul angazhimesh në nivele produktesh/industrish, duke përcaktuar afate kohore specifike dhe veprimet e tjera specifike që nevoiten të ndërmerren për të përmbushur angazhimet respektive. Kjo njësi mund të shërbente edhe si një Sekretariat pune për të hartuar dhe menaxhuar axhendat e mbledhjeve të përbashkëta të të dy qeverive, të cilat duhet të jenë sipas një kalendari fiks, dy herë në vit me rotacion.

Komuniteti i bizneseve në të dy anët e kufirit, por edhe përfaqësues të institucioneve në nivel teknik, bëjnë thirrje për një leadership institucional, koordinues dhe zbatues të iniciativave të ndërmarra me qëllim bashkëpunimin më të fortë ekonomik dhe realizimin e idesë “dy shtete një ekonomi”. Unifikimi dhe forcimi i lidershit institucional në funksion të forcimit të bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve duhet të shoqërohet edhe me unifikimin e masava të marra në një dokument të përbashkët strategjik zhvillimi, pjesë integrale e të cilit të jetë një plan veprimi në të cilin të integrohet plani i zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara mes dy vendeve me afate konkrete dhe njësi përgjegjëse zbatimi në të dy vendet. Plan strategjik duhet të përfshijë dhe mekanizma periodikë monitorimi të impaktit dhe adresimit të efekteve negative. Grupet ndër-institucionale të bashkëpunimit të ngritura, me kontribut të

pazëvendësueshëm në hartimin e marrëveshjeve dy-palëshe, rezultojnë jo-efektivë në stadin e zbatimit dhe monitorimit të progresit për arsye të kompetencave shpesh të segmentuara dhe të kufizuara në zbatim.

Së fundi, aspekte të rëndësishme të koordinimit të politikave ekonomike në nivelin makroekonomik të fokusuara në sektorë strategjikë duhet të jenë në koordinim të plotë me nivelin mikro, atë të agjentëve ekonomikë apo institucionalë (mikro faktorët) duke përfshirë këtu dhe aspektet kulturore të kompanive, të konsumatorëve, aspekte të kulturës institucionale, teknologjisë së prodhimit dhe shërbimit apo dhe stokun e faktorëve të prodhimit që kanë të dy vendet. Në këtë proces, gjithëpërfshirja mbetet element thelbësor.

5. Integrimi ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës është një përpjekje për të krijuar më shumë ekonomi të shkallës dhe ndërtuar një sistem më konkurrues që të përballlet me konkurrencën e shtuar rajonale dhe globale. Ky proces nuk zëvendëson dhe as konkurren me axhendat e tjera integruese në të cilat tashmë të dy vendet janë të përfshira; përkundrazi, eksperiencat pozitive që mund të ndërtohen nga bashkëpunimi bilateral, mund të aplikohen edhe më gjerë. Ashtu sikurse bashkëpunimi mes vendeve të Ballkanit Perëndimor është paraparë nga Bashkimi Europian si një proces ndihmues për integrimin e tyre në BE, edhe integrimi më i fortë ekonomik dhe tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës mund ti shërbejë më mirë proceseve të integritit rajonal.

Nëse do të unifikohehin rregullat e tregtisë, taksat dhe politikat ekonomike, nëpërmjet një qasje strategjik të unifikuar, të institucionalizuar dhe afatgjatë, tregu i përbashkët i dy vendeve prej rreth 5 milionë konsumatorë, do të ishte funksional dhe më konkurrues. Kosova dhe Shqipëria si një treg i përbashkët, me modalitete të ngjashme si ato të tregut të përbashkët Europian, do të ishte një ofertë joshëse edhe për investitorët e huaj. Tërheqja e investitorëve të huaj duhet të jetë një prioritet në hartimin e platformave të bashkëpunimit të dy vendeve. Ky treg i përbashkët do të ishte me konkurrues në rajon duke krijuar mundësi të akumulimit të vlerës si dhe duke shfrytëzuar avantazhe të ndërsjellta, si atë të lëndëve të para, të krahut të punës si dhe kostove të ulëta të transaksioneve ekonomike.

6.1. Udhërrëfyes për krijimin e një ekonomie të unifikuar (Vizioni 2030)

Me qëllim strukturimin sa më të qartë dhe koherent të rekomandimeve të dala nga ky projekt, është hartuar një udhërrëfyes që mund të shërbejë më konkretisht për politikëbërësit dhe grupet e interes për të avancuar axhendën e integritit ekonomik Shqipëri-Kosovë. Më poshtë, janë të përshkruar hapat konkretë që sugjerohet të ndërmerren me qëllim përparimin drejt unifikimit të dy ekonomive:

1. Krijimi i një Struktura dypalëshe (Direktorat), me përgjegjësinë e lidershit për integrimin ekonomik, e drejtuar nga dy bashkëkryetarë. Kjo strukturë duhet të ketë një nivel të lartë përfaqësimi politik dhe të ketë akses në mbledhjet e qeverive përkatëse, në mënyrë që çdo akt juridik dhe çdo problem specifik që ndeshet në këtë proces, të mund të shtrohet për t'u adresuar në nivelet më të larta të qeverisjes. Kjo strukturë mund të jetë një zyrë qendrore në

Prishtinë, ku stafi i punës të jetë i përbashkët dhe funksionimi i saj të financohet nga të dy qeveritë.

2. Në mbështetje të veprimtarisë së këtij institucioni, mund të krijohet dhe një Fond Investimesh i përbashkët, i cili të shërbejë si një instrument financiar për të mbështetur projekte që kontribuojnë në thellimin e integritit ekonomik. Projektet duhet të kenë karakter ekonomik, social, kulturor dhe shkencor dhe që kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë përmes politikave integruese dhe që lehtësojnë më shumë tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik. Direktorati duhet të shërbejë dhe si Bord Drejtues i Fondit.

3. Bazuar edhe në gjetjet e këtij studimi dhe dokumenteve të tjera të mëparshme, të hartohet një dokument i strategjisë së përbashkët të harmonizimit të politikave të zhvillimit ekonomik me synim shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta në mënyrë sa më eficiente. Ky dokument duhet të përcaktojë si objektiv një periudhë 10 vjeçare, me synimin që deri në vitin 2030 të dy vendet të kenë një profil ekonomik, me politika, institucione dhe struktura prodhuese e tregtare të unifikuara dhe/ose të koordinuara. Hartimi i këtij dokumenti të jetë produkt i një angazhimi sa më të gjerë publik, të përfshijë qendra kërkimore e studimore në të dy vendet dhe të ketë një proces sa më të gjerë të konsultimeve me grupet e interesave dhe publikun në tërësi.

4. Strategjia 2030 duhet të vijohet nga hartimi i një plani të veprimit (i detajuar dhe i kostuar) për të plotësuar objektivin e përcaktuar strategjik të dekadës. Ky dokument, që duhet të ketë miratimin e mbledhjes së përbashkët të të dy qeverive, duhet të fokusohet në:

- **Në planin afatshkurtër (1-5 vite):**

- a. Lançimi i një plani mbarëkombëtar promovimi të profileve ekonomike mes dy vendeve. Një plan marketingu dhe komunikimi me publikun për të krijuar më shumë besim mes ofruesve të produkteve dhe shërbimeve. Njohja reciproke dhe krijimi i besimit midis konsumatorëve, prodhuesve dhe institucioneve mbështetëse janë thelbësore në këtë proces.
- b. Eliminimin e të gjithë barrierave jotarifore dhe teknike në tregti. Efektivisht, objektiv parësor duhet të jetë zbatimi i plotë i të gjithë marrëveshjeve të nënshkruara.
- c. Rishikimi i të gjitha kostove të të bërit biznes dhe tregti midis dy vendeve. Tarifat e shërbimeve publike duhen ruajtur në nivelin e mbulimit të kostove, ndërsa liberalizimi shërbimeve të transportit dhe gjithë shërbimeve të tjera ndihmuese për biznesin që ofrohen nga sektori privat duhet të krijojnë një presion për arritjen e niveleve të tyre jo më lart se tarifat e vendeve fqinj për të njëjtat shërbime.
- d. Unifikimin e rregullave, standarteve dhe proceseve të prodhimit dhe tregtimit të mallrave me objektivin që ndërmarrjet prodhuese në të dy anët e kufirit të kenë të njëjtat kërkesa ligjore.
- e. Koordinimin e planeve strategjike në nivele sektoriale, duke identifikuar grupime sektoriale të akumulimit të vlerës. Grupe të përbashkëta pune ndërministrorë, me asistencën e organizatave kërkimore dhe botës akademike, nën drejtimin e Direktoratit duhet të hartojnë plane strategjike zhvillimi dhe të politikave mbështetëse në nivel


sektori dhe produkti. Me prioritet duhen zhvilluar mekanizma mbështetës për industrinë që kanë potencial për bashkëpunim dhe një tregti intensive, siç janë identifikuar në këtë studim.

- f. Njohjen e të gjithë lejeve, licensave, patentave dhe dokumenteve të lëshuara nga administra e njërit vend, edhe në vendin tjetër. Kjo do të krijonte një konkurrencë të shëndetshme midis ofruesve të shërbimeve për bizneset dhe uljen e kostove të të bërit biznes. Parimi i një regjistrimi të vetëm të sipërmarrjeve private gjithashtu duhet të fillojë të zbatohet sa më shpejt. Ndërsa për qëllime fiskale bizneset duhet ti nënshtrohen regjimit të rezidencës, për të gjithë qëllimet e tjera ato zbatojnë të njëjtat rregulla dhe parime. Mbi të gjitha, ky harmonizim do të krijonte kushte për krijimin e një tregu pune unik në të dy anët e kufirit, në mënyrë që profesionistët, artizanët, punëtorët e të gjitha kategorive dhe profesioneve të kenë mundësi të shfrytëzojnë mundësitë që ofron një treg më i gjerë pune. Këtij qëllimi duhet ti shërbej dhe njohja e diplomave nga punëdhënësit në të dy anët e kufirit dhe konkurrimi pa diskriminim për çdo vend pune të ofruar qoftë në sektorin privat por dhe në atë publik.

• **Në planin afatmesëm dhe afatgjatë (viti 5-10):**

- a. Krijimi i skemave të përbashkëta mbështetëse për sipërmarrje dhe tregti. Në veçanti mbështetja për bujqësinë dhe sipërmarrjen e inovacionin duhet të shkrihen duke krijuar struktura të përbashkëta. Ndërsa fondi për zhvillimin e rajoneve të zgjerohet edhe përtej kufirit. Agjensitë publike të shërbimeve mbështetëse duhet të konsiderohen si zgjatime të njëra-tjetrës.
- b. Të shihet mundësia që monedhat euro dhe lekë të përdoren pa kufizime në të dy anët. Pra, tregtarët dhe bizneset e Kosovës të lejohen të përdorin monedhën kombëtare të Shqipërisë, Lekun, pa asnjë kufizim sipas interesave të tyre, njësoj siç përdoren në Shqipëri lirisht dhe pa kufizim të dy monedhat.
- c. Koordinimi i politikave ekonomike e buxhetore, duke hartuar programe buxhetore të përbashkëta për projektet me rëndësi të posaçme për integrimin mes dy vendeve. Në veçanti mund të shikohen projektet në fushën e energjisë dhe infrastrukturës fizike dhe dixhitale të cilat krijojnë një shtrat të shëndetshëm për rritje ekonomike dhe integrim social.
- d. Finalizimi i të gjithë hapave të evidentuar në dokumentet sektoriale në mënyrë që politikat dhe instrumentet mbështetëse sektoriale të jenë plotësisht të përputhura dhe të harmonizuara.

Figura 14. Udhërrëfyshi për integrimin ekonomik 2030



Referenca

ACIT (2014) Raporti i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Banka e Shqipërisë (2018) Tregtia Ndërkombëtare e Mallrave dhe Shërbimeve, Tiranë.

CEFTA (2016) Agreement on amendment of and accession to the Central European Free Trade Agreement, Brussels.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2013) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2014) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2015) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2016) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2017) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2018) Buletini i Tregtisë së Jashtme, Tiranë.

European Commission (2019) Excise duty tables. Part I: Alcoholic beverages, Brussels.

GIZ (2018) Business Process Analysis (BPA) Study - Republic of Albania Trade Procedures, Tiranë.

INSTAT (2013) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

INSTAT (2014) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

INSTAT (2015) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

INSTAT (2016) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

INSTAT (2017) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

INSTAT (2018) Tregtia e Jashtme e Mallrave, Tiranë.

Instituti i Politikave Publike dhe Private (2018) Inventari i tarifave të zbatueshme mbi importet dhe eksportet shqiptare, Tiranë.

Organizata Botërore e Tregtisë (2019) Raport i Sekretariatit mbi tregtinë në mallra të vendeve CEFTA, Komiteti i Marrëveshjeve Rajonale të Tregtisë.

United Nations Economic Commission for Europe (2016) Regulatory and Procedural barriers to trade in Albania. Needs assessment, Geneva.

Shtojca 1. Indeksi i Avantazheve Krahasuese të tregtisë Shqipëri - Kosovë

Kodi HS dhe pershkrimi	2013	2014	2015	2016	2017	2018
11 Produkte të industrisë blujtëse, mjalti, niseshte	19011.44	27168.39	7599.71	4630.31	1539.37	539.75
23 Mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore	3140.45	1184.28	1033.47	2297.47	750.06	420.52
57 Qilimet dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili	90.01	30.69	16.81	6.43	0.25	72.62
22 Pijet, alkoolet dhe uthullat	32.42	47.71	57.37	44.45	48.33	46.29
66 Çadrat e diellit, bastunet etj.	0.00	3.08	0.00	26.30	0.94	23.80
34 Sapuni, preparatet parëse, lubrifikues, qirinjtë	6.08	14.38	19.76	29.56	21.78	23.71
70 Qelqi dhe artikuj prej qelqi	2.26	9.35	6.22	4.50	4.55	18.08
73 Artikuj prej gize dhe çeliku	25.56	15.37	14.97	16.24	13.85	14.08
39 Plastika dhe artikuj prej tyre	11.40	12.56	10.97	12.70	10.91	11.07
10 Drithërat	0.01	39.67	110.76	6.52	3.07	10.13
35 Substancat albuminoidale, enzimat	0.00	2.31	16.15	15.18	5.80	9.84
68 Artikuj prej guri, allçie, çimento, mike, asbesti etj	2.53	1.27	6.65	16.79	10.07	6.65
21 Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	0.46	4.65	4.69	9.70	4.94	6.58
49 Librat, revistat, pikturat dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet	0.26	0.10	3.63	10.02	1.61	6.18
55 Fibrat themelore të bëra nga njerëzit	1.03	0.00	0.00	4.75	1.40	4.85
60 Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4.53

fije						
17 Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	0.51	2.33	3.56	1.42	2.75	3.94
40 Gomë dhe artikuj të tij	3.49	2.75	1.93	1.25	1.87	3.92
30 Produktet farmaceutike	3.09	0.87	0.50	0.65	1.92	3.61
29 Kimikatet organike	0.00	0.00	0.00	0.52	0.00	3.16
18 Kakao dhe përgatitje kakao	1.70	5.85	17.27	10.54	5.97	3.09
72 Giza dhe çeliku	4.73	4.30	3.55	2.21	3.06	2.71
44 Druri dhe artikuj prej druri, qymyri i drurit	0.37	0.49	0.57	1.53	1.87	2.42
31 Plehëruesit	0.00	0.00	0.00	0.84	3.80	2.23
90 Instrumentat dhe aparatet optike, fotogr., kinematogra. etj.	0.10	0.01	0.18	0.01	0.01	2.14
32 Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike, stukot dhe mastiçet, bojrat	1.65	3.37	3.58	2.10	1.77	2.07
76 Alumini dhe artikuj prej tij	2.36	4.08	3.61	3.09	1.55	1.87
04 Produkte bulmetore, vezët, mjalti	4.39	33.79	11.09	16.21	7.77	1.87
15 Vajra dhe dhjamra kafshore apo vegjetale	0.00	0.00	0.00	0.00	1.43	1.33
96 Artikuj të ndryshëm të prodhuar	4.94	2.60	1.41	1.14	0.91	1.24
20 Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave, etj.	0.92	1.24	1.85	1.74	1.36	1.09
19 Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit	0.39	0.49	1.21	1.87	1.15	1.09
94 Mobileritë, krevat, dyshekët, llampat dhe pajisjet e ndriçimit etj	0.38	0.68	0.48	0.47	0.69	1.03
48 Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letres dhe të kartonit	0.17	0.06	0.15	0.37	1.01	0.87
09 Kafe, çaj dhe erëza	13.65	13.47	10.99	17.79	10.78	0.78
38 Produkte të ndryshme kimike	0.17	0.89	0.06	0.93	0.76	0.60
84 Reaktorët nuklearë, bolierët, makineritë e pajisjet mekanike	0.60	1.37	0.45	0.55	0.17	0.56
28 Kimikatet inorganike, përbërjet organike	0.00	0.03	0.01	0.00	0.00	0.49
16 Ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku, molusqe, etj.	0.06	0.38	0.61	0.60	0.37	0.48
02 Mish dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	0.28	1.05	2.22	2.38	1.38	0.48
07 Zarzavatet e ngrënshme dhe rrënjët e tuberat përkatëse	5.02	3.89	2.43	2.32	1.05	0.40
63 Artikuj të tjerë tekstile të ndërt., veshjet e përd., lecka mbetu.	0.03	0.05	0.09	0.05	0.12	0.29
87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonat e hekurudhës	0.81	0.73	0.47	0.62	0.18	0.19
33 Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, përg. e parf., kozmetikës, tualetit	0.12	0.13	0.59	0.36	0.06	0.17
79 Zinku dhe artikuj prej tij	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.15
69 Produkte qeramike	0.07	0.02	0.08	0.11	0.36	0.14
08 Frutat dhe arrat e ngrënshme	0.03	0.02	0.04	0.03	0.03	0.12
86 Lokomotivat e trenave, vagonat dhe pjesët e tyre	0.00	0.00	2.00	0.00	0.00	0.09
12 Farat vajore, bimët industriale apo medicinale, ushqim për kafshët	0.00	0.00	0.01	0.09	0.08	0.08
25 Kripërat, sulfuret, oksidet, gëlqere dhe	0.41	0.05	0.52	0.11	0.01	0.07

çimento						
99 Te tjera	0.00	0.00	0.02	0.00	0.00	0.06
56 Mbushjet shajak dhe pëlhura të paendura	0.00	0.71	0.00	0.00	0.00	0.06
27 Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre	0.00	0.00	0.01	0.01	0.01	0.05
58 Pëlhurat speciale të endura, tantella, tapiceri, qëndisimat	0.01	0.00	0.00	0.00	0.00	0.03
06 Pemët dhe bimët, rrënjët, lulet dhe gjethet zbukuruese	0.00	0.36	0.35	0.16	2.29	0.03
85 Makineri dhe pajisjet elektrike dhe pjesët e tyre	0.11	0.22	0.10	0.19	0.16	0.02
61 Artikuj të veshjes dhe rroba plotësuese, të thurura	0.00	0.00	0.01	0.01	0.00	0.01
26 Xeherorët, zgjyrat dhe hiri	0.00	0.19	0.00	0.00	0.00	0.01
41 Lëkurët e papërpunuara dhe të përpunuara	0.04	0.00	0.00	0.13	0.00	0.00
82 Veglat e punës, pajisjet e punës, takëmet e ngrënies etj	0.13	0.34	0.04	0.75	0.04	0.00
62 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjes jo të thurura	0.00	0.00	0.01	0.01	0.01	0.00
64 Veshjet e këmbëve	0.01	0.02	0.02	0.01	0.00	0.00
83 Artikuj të ndryshëm prej metali bazë	0.00	0.01	0.06	0.04	0.00	0.00
42 Artikuj prej lëkure	0.19	0.25	0.06	0.00	0.00	0.00
97 Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	13.75	0.00	107.98	2.82	22.70	0.00
89 Anijet, varkat dhe strukturat lundruese	0.00	0.00	0.00	0.00	2.32	0.00
54 Filamentet e bëra nga njerëzit	0.00	0.00	0.00	0.00	1.63	0.00
67 Puplat dhe pushi i përgatitur, lulet artificiale					0.92	0.00
95 Lodrat dhe pjesët plotësuese të tyre	0.07	0.04	0.08	0.04	0.16	0.00
59 Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbul. apo të laminu.	0.00	0.25	0.45	0.00	0.11	0.00
03 Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme	0.00	0.00	0.03	0.02	0.01	0.00
74 Bakri dhe artikuj prej bakri	0.00	0.03	0.04	0.00	0.00	0.00
92 Instrumentat muzikore pjesët e tyre	0.00	0.00	0.00	37.59	0.00	0.00
65 Veshjet e kokës	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
24 Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	0.00	0.00	0.06	0.00	0.00	0.00
78 Plumbi dhe artikuj prej tij	0.00	0.00	0.01	0.00	0.00	0.00
46 Prodhimet e kashtës, punimet në xunkth e në kallama	0.00	0.69	0.00	0.00	0.00	0.00
01 Kafshë të gjalla	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
05 Produkte me origjinë kafshore të papërfshira diku tjetër	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
13 Rreshrat dhe lëngje e ekstrakte të tjera vegjetale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
14 Materiale vegjetale që përdoren për thurje	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
36 Eksplozivët, produktet piroteknike, shkrepset	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
37 Mallrat fotografike dhe kinematografike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
43 Gëzofët dhe qimet artificiale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
47 Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze celulozike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
51 Leshi, qime kafshësh të holla	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

52 Pambuku	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
71 Perlat natyrale, gurët e çmuar, bizhuteritë, monedhat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
88 Avionët, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
91 Orët e të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
45 Tapa dhe artikuj prej tape	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00
81 Metale të tjera bazë	0.00			0.00	0.00	0.00
53 Fibra të tjera tekstile vegjetale		0.00	0.00		0.00	0.00
50 Mëndafsh	0.00		0.00	0.00		0.00
75 Nikeli dhe artikuj prej tij	0.00					0.00
80 Kallaji dhe artikuj prej tij					0.00	

Shtojca 2. Indeksi Grubel-Lloyd për tregtinë midis industrive

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
01 Kafshë të gjalla	0	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
02 Mish dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	0.00	0.33	0.00	0.20	0.03	0.00
03 Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme	0.00	0.00	0.00	0.01	0.00	0.00
04 Produkte bulmetore, vezët, mjalti	0.17	0.15	0.15	0.14	0.13	0.06
05 Produkte me origjinë kafshore të papërfshira diku tjetër	0	0	0	0	0	0.00
06 Pemët dhe bimët, rrënjët, lulet dhe gjethet zbukuruese	0.00	0.03	0.03	0.03	0.03	0.00
07 Zarzavatet e ngrënshme dhe rrënjët e tuberat përkatëse	0.12	0.13	0.06	0.02	0.14	0.10
08 Frutat dhe arrat e ngrënshme	0.14	0.14	0.19	0.08	0.07	0.04
09 Kafe, çaj dhe erëza	0.12	0.05	0.10	0.09	0.14	0.00
10 Drithërat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
11 Produkte të industrisë bluajtëse, mjalti, niseshte	0.00	0.02	0.01	0.01	0.01	0.09
12 Farat vajore, bimët industriale apo medicinale, ushqim për kafshët	0.00	0.00	0.00	0.14	0.11	0.06
13 Rreshrat dhe lëngje e ekstrakte të tjera vegjetale	0	0.00	0.00	0	0	0
14 Materiale vegjetale që përdoren për thurje	0	0	0	0	0	0.00
15 Vajra dhe dhjamra kafshore apo vegjetale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.07
16 Ushqimet e përgatitura prej mi-shi, peshku, molusqe, etj.	0.28	0.00	0.00	0.13	0.04	0.03
17 Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	0.18	0.11	0.58	0.38	0.34	0.38
18 Kakao dhe përgatitje kakao	0.39	0.33	0.45	0.87	0.97	0.67
19 Përgatitjet prej drithërave, mie-	0.02	0.18	0.10	0.25	0.13	0.17

llit, niseshtes apo qumështit						
20 Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave, etj.	0.28	0.34	0.35	0.54	0.34	0.36
21 Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	0.11	0.29	0.18	0.30	0.26	0.23
22 Pijet, alkoolët dhe uthullat	0.14	0.14	0.05	0.04	0.04	0.07
23 Mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore	0.27	0.00	0.00	0.00	0.10	0.04
24 Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	0	0	0.60	0	0.00	0.00
25 Kripërat, sulfuret, oksidet, gëlqere dhe çimento	0.04	0.03	0.02	0.01	0.08	0.06
26 Xehororët, zgjyrat dhe hiri	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
27 Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre	0.02	0.00	0.10	0.00	0.00	0.10
28 Kimikatet inorganike, përbërjet organike	0.00	0.00	0.07	0.00	0.04	0.01
29 Kimikatet organike	0	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
30 Produktet farmaceutike	0.52	0.14	0.09	0.10	0.38	0.18
31 Plehëruesit	0	0	0.00	0.00	0.00	0.00
32 Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike, stuket dhe mastiçet, bojrat	0.19	0.12	0.21	0.12	0.17	0.15
33 Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, përg. e parf., kozmetikës, tualetit	0.35	0.18	0.16	0.28	0.24	0.17
34 Sapuni, preparatet parëse, lubrikues, qirinjtë	0.59	0.51	0.34	0.21	0.16	0.14
35 Substancat albuminoidale, enzimmat	0.00	0.33	0.27	0.45	0.15	0.01
36 Eksplozivët, produktet piroteknike, shkrepset	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
38 Produkte të ndryshme kimike	0.12	0.04	0.01	0.05	0.10	0.07
39 Plastika dhe artikuj prej tyre	0.32	0.30	0.17	0.31	0.25	0.34
40 Gomë dhe artikuj të tij	0.00	0.01	0.06	0.22	0.11	0.03
41 Lëkurët e papërpunuara dhe të përpunuara	0.00	0.14	0.00	0.00	0.00	0.00
42 Artikuj prej lëkure	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
44 Druri dhe artikuj prej druri, qymyri i drurit	0.31	0.11	0.17	0.16	0.10	0.15
45 Tapa dhe artikuj prej tape	0	0.00	0	0	0	0.00
46 Prodhimet e kashës, punimet në xunkth e në kallama	0	0.00	0	0	0	0
47 Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze celulozike	0	0.00	0	0	0	0.00
48 Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letrës dhe të kartonit	0.21	0.10	0.16	0.33	0.12	0.16
49 Librat, revistat, pikturat dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet	0.06	0.08	0.19	0.09	0.08	0.07
51 Leshi, qime kafshësh të holla	0	0	0.00	0	0	0

52 Pambuku	0.00	0	0	0	0	0
54 Filamentet e bëra nga njerëzit	0	0.00	0.00	0.00	0.52	0.00
55 Fibrat themelore të bëra nga njerëzit	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00
56 Mbushjet shajak dhe pëlhura të paendura	0.00	0.04	0.00	0.00	0.00	0.05
57 Qilimet dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili	0.00	0.02	0.00	0.15	0.00	0.00
58 Pëlhurat speciale të endura, tantella, tapiceri, qëndismat	0.00	0	0	0	0.00	0.00
59 Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbul. apo të laminu.	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0
60 Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije	0	0	0	0.00	0.00	0.00
61 Artikuj të veshjes dhe rroba plotësuese, të thurura	0.08	0.09	0.01	0.10	0.07	0.17
62 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjes jo të thurura	0.00	0.03	0.16	0.20	0.14	0.29
63 Artikuj të tjerë tekstile të ndërt., veshjet e përd., lecka mbetu.	0.02	0.00	0.03	0.36	0.12	0.06
64 Veshjet e këmbëve	0.25	0.21	0.31	0.10	0.11	0.03
65 Veshjet e kokës	0	0	0.00	0.00	0	0
66 Çadrat e diellit, bastunet etj.	0.00	0.19	0.00	0.00	0.58	0.22
67 Puplat dhe pushi i përgatitur, lulet artificiale	0	0	0	0	0.00	0
68 Artikuj prej guri, allçie, çimento, mike, asbesti etj	0.03	0.27	0.09	0.19	0.05	0.03
69 Produkte qeramike	0.15	0.00	0.10	0.01	0.04	0.07
70 Qelqi dhe artikuj prej qelqi	0.18	0.13	0.27	0.18	0.10	0.14
72 Giza dhe çeliku	0.10	0.00	0.02	0.07	0.08	0.02
73 Artikuj prej gize dhe çeliku	0.15	0.30	0.22	0.15	0.24	0.34
74 Bakri dhe artikuj prej bakri	0	0.00	0.00	0.00	0.00	0
76 Alumini dhe artikuj prej tij	0.13	0.00	0.08	0.11	0.06	0.26
78 Plumbi dhe artikuj prej tij	0	0	0.00	0	0	0
79 Zinku dhe artikuj prej tij	0	0	0	0	0	0.00
82 Veglat e punës, pajisjet e punës, takëmet e ngrënies etj	1.00	0.16	0.45	0.17	0.00	0.01
83 Artikuj të ndryshëm prej metali bazë	0.00	0.21	0.14	0.01	0.00	0.00
84 Reaktorët nuklearë, bolierët, makineritë e pajisjet mekanike	0.23	0.15	0.09	0.14	0.16	0.09
85 Makineri dhe pajisjet elektrike dhe pjesët e tyre	0.18	0.16	0.13	0.14	0.11	0.04
86 Lokomotivat e trenave, vagonat dhe pjesët e tyre	0	0	0.00	0	0	0.00
87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonat e hekurudhës	0.47	0.16	0.25	0.11	0.26	0.00
88 Avionët, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre	0.00	0	0	0	0	0
89 Anijet, varkat dhe strukturat lundruese	0	0	0	0	0.00	0

90 Instrumentat dhe aparatet optike, fotogr., kinematogra. etj.	0.00	0.00	0.04	0.00	0.21	0.12
92 Instrumentat muzikore pjesët e tyre	0	0	0	0.70	0	0
94 Mobileritë, krevat, dyshekët, llambat dhe pajisjet e ndriçimit etj	0.23	0.33	0.21	0.21	0.22	0.14
95 Lodrat dhe pjesët plotësuese të tyre	0.00	0.72	0.46	0.09	0.17	0.00
96 Artikuj të ndryshëm të prodhuar	0.00	0.00	0.01	0.00	0.00	0.00
97 Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	0.69	0.00	0.12	0.34	0.52	0.00
99 Te tjera	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0.00

Shtojca 3. Përmbledhje e detajuar e gjetjeve nga pyetësorët me sipërmarrësit mbi barrierat tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës.

1. Republika e Kosovës shfaq problemin e pabarazisë në trajtimin doganor në pikat e saj të kalimit të kufirit (PKK). Mallrat dhe shërbimet e ofruara nga territori i Republikës së Serbisë trajtohen në mënyrë preferenciale, nuk paguajnë detyrimet e sakta doganore, duke konkurruar padrejtësisht produktet dhe shërbimet shqiptare. Në fushën e materialeve të ricikluara, psh, produktet serbe janë nga 16- 25 % më të lira, pikërisht për këtë arsye.
2. Në pikat e kalimit të kufirit Shqipëri-Kosovë realizohen dy kontrolle doganore, në ndryshim nga Veriu i Kosovës, psh ku nuk ka kontroll doganor dhe mallrat hyjnë pa doganë.
3. Në fushën e materialeve ricikluese, për shkak të konkurrencës së pandershme nga ky trajtim doganor (dhe kostot që shoqërojnë produktet), eksportet shqiptare, nga rreth 10 milionë euro të realizuara para dy-tre vitesh, aktualisht janë vetëm rreth 1,5-2 milionë Euro. (Kujtojmë që në Shqipëri ushtrojnë këtë veprimtari 10 kompani të plastikës, 1 kompani e përpunimit të letrës, 5 kompanit të riciklimit të metaleve me ngjyra- Investimet e tyre shkojnë rreth 100 milionë euro, rreth 30-35 e prodhimit të tyre shkon në Kosovë, por edhe pse me koston më të ulët në treg, nuk konkurron dot produktet pa doganë që vijnë nga Serbia)
4. Industria e miellit që ka një investim në total prej afër 150 milionë euro në vend, nuk arrin të jetë konkurruese në Kosovë.
5. Nuk ka standarde të unifikuara mes të dy vendeve dhe as të njehsuara me ato të BE-së

6. Kërkohet të unifikohet certifikata e lëvizjes EURO 1 (Shënim: Kosova nuk është pjesë e marrëveshjeve të kumulimit diagonal, PEM, ndërsa vështirësia qëndron në përfitimin e origjinës së mallrave dhe shërbimeve).
7. Në fushën e ofrimit të shërbimit shëndetësor privat, në Kosovë, kompanitë shqiptare kanë investuar disa dhjetra milionë euro. Probleme identifikohen në eksportimin e produkteve shëndetësore, të cilat duhet të rregjistrohen në doganë me një procedurë të rënduar dhe të papërbalueshme, ndërkohë që nga Serbia importohen pa doganë.
8. Në fushën e tregut të sigurimeve, kompanitë shqiptare kanë investuar rreth 15 milionë Euro në Kosovë. Ka diversifikim në trajtimin fiskal të kompanive shqiptare me ato kosovare. Një taksë 7 % mbi xhiron.
9. Policat e sigurimit të automjeteve shqiptare nuk janë të vlefshme për të dy shtetet. 7 kompani kosovare nuk paguajnë dëmet për policat e sigurimit, të lëshuar në Shqipëri. E njëjtë është situata edhe në Shqipëri. Propozohet që policët e sigurimit të jenë të vlefshme për të dy shtetet, pavarësisht kush i lëshon ato.
10. Në fushën e materialeve të ndërtimit dhe të prodhimit të çimentos problemet kryesore kanë të bëjnë me tarifat në transport (referencat), që janë 400 Euro+TVSH. Kësaj kosto i shtohen edhe kostot e agjencive doganore (2x15 Euro).
11. Çdo ditë në Kosovë vetëm nga dy fabrika shqiptare (janë gjithsej 13 të tilla me një xhiro të deklaruar 70-80 milionë euro)) kalojnë jo më pak se 50-80 kamionë. Kamionët shqiptarë paguajnë taksë për peshën për kamion, nuk lejohet kamion mbi 40 Ton, ndërkohë që standardi europian e njeh këtë taksë si peshë/aks.
12. Në fushën e materialeve të ndërtimit dhe çimentos, më shumë se 50 % e përbëjnë eksportet nga Shqipëria. Qeveria e Kosovës dhe dogana e këtij shteti aplikon sistemin e tranzitit në terminale, që ka një kosto të konsiderueshme për këtë sektor. Importet nga Serbia nuk e përfitojnë këtë procedurë. (tregu i çimentos në Kosovë, në 50 % të tij i përket Serbisë).
13. Sipërmarrjet kërkojnë unifikimin e dokumentacionit të import-eksportit me Kosovën.

Sa i përket barrierave:

14. Tarifat e larta për kryerjen e procesit të zhdoganimit.
15. Transporti i produkteve UHT me konteiner frigoriferik;
16. Mos publikimi në faqen zyrtare të Republikës së Kosovës të çmimeve të referencës.
17. Detyrimi për kryerjen e analizave të produktit, ndonëse ISUV është akredituar për një seri analizash, por nuk njihen nga autoritetet doganore të Republikës së Kosovës;
18. Kostot e parkimit doganor në Republikën e Kosovës;
19. Taksa e produkteve të Komunitetit Evropian që eksportohen në të dy shtetet;
20. Problematika e rivlerësimeve, një nga efektet e rivlerësimeve ka të bëjë nga ana financiare, duke rritur bazën e vlerës doganore nga 80% në 300 %.

21. Koha e gjatë për kryerjen e procesit të zhdoganimit;
22. Rishikimi i profileve të riskut për mallrat drejt Republikës së Kosovës;
23. Procedura e kontrollit të produkteve në doganë e cila zgjat deri në orën 14:00.
24. Sa i takon kësaj problematike, DHTIT, që është në rolin e koordinatorit për Shqipërinë, i ka adresuar këto shqetësime Odës Ekonomike të Kosovës, që është koordinatore.
25. Kompanitë në fushën e tregut të fruta-perimeve kanë shënuar ecuri pozitive në rritjen e eksporteve. Problemet dhe ngërçi kryesor që janë hasur:

i) Thjeshtësimi i procedurave doganore.

ii) Heqja e tarifave doganore.

iii) Radhët e gjata në dogana ku shumëherë kamionët detyrohen të qëndrojnë mbi 24 orë në dogana, (radhë, të cilat shkaktohen për mosshkrimin e sporteleve nga ana e policisë kufitare.)

26. Të gjitha veprimet doganore janë njësoj si të eksportosh në Greqi ose në Serbi. Pra nuk vërehen lehtësitë e premtuara dhe të nënshkruara në marrëveshje dypalëshe. Vonesat janë të pa justifikueshme dhe, për fat të keq dhe kostot janë të larta gjë që pengon marrëdhëniet ekonomike midis shqiptarëve andej dhe këtej kufirit.

27. Tarifa të larta për kryerjen e procesit të zhdoganimit. Diferenca në tarifën e terminaleve dhe shërbimeve janë një pengesë serioze në tregtinë midis dy vendeve.

(*) Shënim: 28 EUR pagesa standarde për kamion me 20 ton mall plus 2 EUR / ton

No.	Përshkrimi	Shqipëri	Kosovë
1	Tarifa për Agjensinë Doganore	25	30
2	Pagesë Terminali	10	40
3	Çertifikata Fito-Sanitare	15	68 (*)
4	Tarifa e Skanerit (vetëm në Shqipëri)	22	
5	Tarifa e Transportit Rrugor (Rruga e Kombit)	16	
	Totali	88 Euro	138 Euro

28. Çmimet e Referencës - në praktikë, në disa raste, zyrtarët e doganave vazhdojnë të aplikojnë çmimet e referencës për të llogaritur vlerën doganore. Autoritetet përmendin nënfaturimin si arsye kryesore për këtë masë paraprake. Shqipëria publikon çmimet në faqen zyrtare të internetit, ndërsa Kosova nuk e bën atë. Çmimet e Kosovës janë në dispozicion vetëm gjatë procedurës së zhdoganimit.

29. Standardet - Detyrimi për kryerjen e analizave të produktit nga laboratorë të akredituar në vendin pritës, Kosovë ose të tjerë laboratorë të akredituar në vende të tjera jashtë Shqipërisë, ndonëse ISUV është akredituar për një seri analizash, të cilat megjithatë nuk njihen nga autoritetet doganore të Kosovës. Gjithashtu analizat e produktit nuk bëhet mbi bazën e një analize risku të deklaruar më parë, por për çdo ngarkesë.
30. Bizneset shqiptare të industrisë ushqimore, ankohen për import të produkteve kosovare me parametra nën standardet e lejuara nga shteti Shqiptar për mallra të caktuara. Përmendim rastin e miellit me destinacion prodhim buke, i cili importohet në Shqipëri nga Kosova me nivel të ulët proteine, nën standartin e kërkuar prej 12.5%.
31. Është evidentuar se transporti në Kosovë vijon të sjellë një kosto të papërballueshme për subjektet tona, për shkak të tarifave të aplikuara, të cilat e bëjnë jo-konkurrues çdo produkt shqiptar që ka destinacion Kosovën.
32. Trajtimi i përfshirjes së shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara deri në vendin e paraqitjes së tyre në Kosovë, si dhe harmonizimi dhe implementimi i drejt i procedurës së deklarimit dhe përllogaritjes së shpenzimeve të transportit në bazën doganore, përfshin kushtet e dërgesës sipas paritetit, që nënkupton pjesëmarrjen apo jo të shpenzimeve të dërgimit (transportit, sigurimit, ngarkim-shkarkimit, huazimit, ndërmjetësimit dhe të ngjashme) në vlerën doganore të mallrave dhe realizohet sipas legjislacionit doganor të së Kosovës. Sipas këtij legjislacioni, kalkulimi i shpenzimeve të transportit rrugor realizohet duke përdorur kriterin e largësisë, shprehur në kilometra dhe çmimin 1.50 €/km, duke iu shtuar shuma fillestare prej 200 €, si një shumë ku përfshihen: shpenzimet e amortizimit e mirëmbajtjes së mjetit të transportit, taksat rrugore, vonesat, taksat e terminaleve, mëditjet e vozitësit, dhe të ngjajshme dhe kësaj shume i shtohen kilometrat deri në kufirin e Kosovës. Në rastet kur dërgesat vijnë nga portet e ndryshme, në shpenzimet e transportit kalkulohet edhe shuma fikse prej 250 €; Tek automjetet me pajisje ftohëse po ashtu edhe tek transporti special, vlerës së kalkuluar të shpenzimeve i shtohet edhe 20% e shpenzimeve totale.
33. Lidhur më tarifat e terminaleve shqiptare, rezulton se ka një sërë kostosh për parkim dhe peshim dhe rrisin kostot totale për biznesin.